

“Kadare është një shkrimtar i madh. Jam shumë i pikëlluar për vdekjen e tij. Jam takuar me Kadarenë në vitin 1998 në Torino dhe më pas kemi komunikuar herë pas here më anë të faksit. Do të kisha shumë dëshirë të vija në Shqipëri e të vizitoja shtëpinë e Kadaresë”.

YU HUA:

Kadareja dhe “Ora e gjermanishtes” e SIEGFRIED LENZ

Përktheu nga kinezishtja Iljaz Spahiu

Ju ftojmë në Panairin e Librit “Tirana 2024” në Pallatin e Kongreseve 13 deri 17 nëntor

SHËNIME MBI LIBRAT

Rreth romanit “Kohëstrehim” të Georgi Gospodinov, estetika e tij

Të gjallë si në një muze të së shkuarës, në klinikën pa të tashme

Nga Visar Zhiti (fq. 4)

Vëllimi poetik nga Lulzim Tafa

Ekspozitë me ëndrra (fq. 11)

Parathënie nga Besnik Mustafaj

Përmbledhja poetike e G. Krasniqit

PO TI, KUSH JE (fq. 16)

Nga Giuseppe Schirò Di Maggio

Versionet në gjuhën angleze të veprës së nobelistes Han Kang janë vlerësuar shumë. A janë besnike ndaj origjinalit?

HAN KANG DHE NDËRLIKIMET E PËRKTHIMIT

Jiayang Fan, *The New Yorker*

Përktheu: Granit Zela (fq. 22)

ODISEAS ELITIS

Aksion Esti



Shqipëroi nga origjinali:
NIKO KACALIDHA

OnufriPoezi



Yu Hua është një nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë së sotme kineze.

Vëllimi poetik “Aksion Esti” nga Odiseas Elitis, përkthyer nga Niko Kacalidha,

Një Elitis brenda meje...

Ese nga Niko Kacalidha

Një Elitis brenda meje dhe rreth meje. Edhe është edhe s’është vegim. Para meje librat e tij që m’i dërgoi kohët e fundit me autografin klasik: “Niko Kacalidhës, përzemërsisht, me dashuri, miqësisht. Odiseas Elitis.” Dhe putha shkrimin e bukur sikur të puthja mermeret greke. Sikur të puthja dorën e tij. Sikur t’i lutesha një perëndie. Elitohynisë. Kështu prej asaj dore puth të gjitha perënditë e tjera të grekëve. (fq. 8)

FRAGMENTE NGA LIBRAT E RINJ NË PANAIR

Agron Tufa (fq. 9)

Njeriu buzë lumit

Durim Taçi (fq. 10)

Lakimi

Elida Buçpapaj (fq. 12)

Skaterr

Skënder Buçpapaj (fq. 13)

Zogu i bjeshkës i riu

Charles King (fq. 14)

Mesnatë në Pallatin Pera

Përktheu: Zana Harxhi Baroni

Sandrone Dazieri (fq. 14)

Mbreti i parave

Përktheu nga origjinali: Edmond Çali

Natasha Lester (fq. 15)

Fotografja franceze

Përktheu nga origjinali: Sidita Hoxhiq

Virgjil Muçi (fq. 17)

Tri jetët e zotit P.

Robert Galbraith (fq. 18)

Zemër sterrë e zezë

Milan Kundera (fq. 19)

Festa e kotësisë

Përktheu nga origjinali: Saverina Pasho

Donatella di Pietrantonio (fq. 20)

Mosha e brishtë

Përktheu nga origjinali: Diana Kastrati

Paul Lynch (fq. 21)

Kënga e profetit

Përktheu: Loran Gami

Botohet për herë të parë në shqip

“PORTOKALL MEKANIK” i ANTHONY BURGESS


Përkthyer nga Durim Taçi (fq. 6)



Më datë 25 tetor 2024, Biblioteka e Qytetit të Shkodrës “Marin Barleti” vlerësoi me çmimin “Koliqi” dy shkrimtarë, Ridvan Dibrën dhe Andreas Dushin

Verën e vitit 1998, jam takuar me shkrimtarin shqiptar Ismail Kadare në Torino të Italisë. Ulur në një restorant të Teatrit të Torinos, bisedonim nëpërmjet përkthyesit, ndërsa në mungesë të tij shijonim ushqimet e pijet. Atë kohë, Kadare kishte emigruar në Francë, kështu që mund të quhej shkrimtar francez me origjinë shqiptare. Në fillim të viteve 90-të, Shtëpia Botuese e Shkrimtarëve në Kinë kishte botuar romanin e tij “Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur”, dhe unë për fat e kisha lexuar këtë libër. Me shumë gjasë ai është shkrimtari më i rëndësishëm bashkëkohor i Shqipërisë dhe ashtu si shkrimtarë të tjerë të Evropës Lindore që kishin emigruar në perëndim, për disa kohë nuk mund të kthehej në vendin e tij. Kur u takuam ne, nuk ekzistonte më ky problem dhe ai mund të kthehej sa herë të dëshironte. Megjithatë ai më tha se nuk kthehej shumë shpesh dhe kjo për shkak se sa herë kthehej, lodhej së tepërmi. Më tregoi se çdo herë që kthehej, shtëpia e tij në Tiranë gumëzhinte si një pijetore, njerëz të njohur e të panjohur vinin për ta vizituar dhe gjithmonë në shtëpi do të kishte minimumi njëzet vetë.

Duke qenë se dikur Kina dhe Shqipëria megjithëse larg njëri tjetrit kishin përjetuar një miqësi të ngushtë si fqinjë të mirë, si unë edhe Kadareja ndjeheshim shumë të gëzuar e të emocionuar në bisedë me njëri tjetrin. Unë i përmenda Hoxhën e Shehun, ai më përmendi Mao Ce Dunin dhe Çu En Lain. Kadareja e kishte vizituar Kinën gjatë Revolucionit Kulturor dhe shqiptonte shumë saktë emrat e tyre. Një kritik letrar italian aty pranë, përpiqej herë pas herë të përfshihej në bisedën tonë, por pa sukses, pasi ai nuk kishte përjetuar historinë tonë. Të zënë me kujtimet tona plot emocion, ne nuk kishim kohë të merreshim me të, megjithëse ai njëherë tentonte të më provokonte mua duke përmendur dënimin me vdekje në sistemin ligjor të Kinës, një herë tentonte të tërhiqte vëmendjen e Kadaresë duke i përmendur Kosovën dhe persekutimin e serbëve ndaj shqiptarëve.



“Kadare është një shkrimtar i madh. Jam shumë i pikëlluar për vdekjen e tij. Jam takuar me Kadarenë në vitin 1998 në Torino dhe më pas kemi komunikuar herë pas here më anë të faksit. Do të kisha shumë dëshirë të vija në Shqipëri e të vizitoja shtëpinë e Kadaresë”.

YU HUA:

Kadareja dhe “Ora e gjermanishtes” e Siegfried Lenz

Përktheu nga kinezishtja Iljaz Spahiu



Më pas biseda jonë kaloi tek letërsia dhe nuk e di për çfarë arsyeje, filluam të flasim për shkrimtarin gjerman Siegfried Lenz, ndoshta nga që të dy ne e pëlqenim romanin e tij “Ora e Gjermanishtes”. Ky roman, i cili mund të cilësohej si një

libër antifashist, ishte botuar edhe në vendet socialiste të asaj kohe.


Kadare më rrëfeu historinë e tij të “Ora e Gjermanishtes”. Ai më tregoi se si një herë, pasi përfundoi së shkruari një libër që ishte e pamundur ta botonte në Shqipëri,

mendoj ta kalonte ilegalisht në perëndim për botim. Përdori një mënyrë tepër fine e të zgjuar, e fshehu dorëshkrimin brenda librit dhe e nxori jashtë ilegalisht, pasi i kishte vënë me kujdes kopertinën e librit “Ora e Gjermanishtes” dhe e ngjiti mbi librin e tij, si kopertinë të librit. Në këtë mënyrë, gjermani Lenz e ndihmoi shqiptarin Kadare, të kalojë me sukses kontrollin doganor të këtij libri sipas mënyrës “Var kokë qengji e shit mish qeni”, duke e çuar atë në Francë dhe shumë vende të tjera, deri sa më vonë erdhi edhe në Kinë.


Edhe unë rrëfeva historinë time të “Ora e Gjermanishtes”. Libri i parë i Lenz që unë kisha lexuar ishte “Bukë dhe Lojëra”, i dyti ishte “Ora e Gjermanishtes”. Atë kohë studioja në Institutin Letrar Luxun dhe më kujtohet që ky libër më tronditi së tepërmi. Në rrëfimin e pafajshëm të një fëmije, unë përjetova gjatë leximit emocione të forta tronditëse. Ai ishte një roman që pasi e ke lexuar, nuk dëshiron ta humbasësh më, kështu që unë nuk ia ktheva më bibliotekës së shkollës. Ky libër është përkthyer në gjuhën kineze dhe është botuar në vitet 80-të. Atë kohë sektori i botimeve funksiononte sipas ekonomisë së planifikuar, shumica dërmuese e librave botoheshin vetëm një herë, nëse arrije ta bleje mirë, në të kundërt nuk e bleje dot kurrë. Kështu që unë e dija se po të ia ktheja bibliotekës, ndoshta do ta humbja atë përgjithmonë. E mbajta pranë vetes, deri sa kur përfundova duhej të ktheja të gjithë librat që kisha marrë në bibliotekë, përndryshe do të gjobitesha me trefishin e çmimit të librit. Sigurisht që zgjodha gjobitjen, duke thënë që e kam humbur librin. E mora me vete në Zhejiang dhe sërish e mora me vete edhe më pas kur u vendosa në Pekin.

Dhe ja në vitin 1998, një kinez dhe një shqiptar, takohen në vendin e quajtur Itali dhe secili prej tyre rrëfen historinë e tij që ka lidhje me një gjerman. Atë moment mendova se letërsia është vërtet një bukuri pa kufi. Ajo, ashtu siç iu ngulitet në mendje njerëzve nëpërmjet leximit, po ashtu mbahet mend prej tyre nëpërmjet mënyrave nga më të ndryshmet.

Tetor 2004



Shkrimtari i shquar kinez Yu Hua dhe përkthyesi i tij shqiptar z. Iljaz Spahiu, javën e shquar janë takuar në Shanghai



Siegfried Lenz, "Hija", përkthyer nga I.Kadare

Me këtë titull, Kadareja nxori nga Shqipëria dorëshkrimin e romanit "Hija"

Për herë të parë përmendet ky fakt nga shkrimtari në librin e tij "Dialog me Alain Bosquet"

A. B. - Gjatë viteve 1981-1982, në veprën tuaj nuk shohim asnjë gjurmë të kësaj tiranie. Si mund të shkruanit ju "normalisht" në këtë atmosferë terrori? A mund të na flisni pak për ditën tuaj të punës?

I. K. - Në librin "Ftesë në studio" kam folur për kalendarin e dytë të shkrimtarit. Kyçi i enigmës së qëndrësës së një shkrimtari përmbledhet në një shpjegim, që duket i thjeshtë: sa mundi ai në stinën e egër, të strehohet në këtë kalendar tjetër, si të thash, në shtëpinë e tij të dytë?

Kjo shtëpi eterne është emërtuar gjithfarësoj: banesë qiellore, kullë e fildishtë, parnas, mërgim i brendshëm. Unë do ta quaja thjesht kohë e dytë e shkrimtarit dhe është diçka më e thellë se ato që përmenda më lart. Ndoshta, ajo lind me shkrimtarin dhe përbën thelbin e asaj që quhet dhunti. Ajo është quajtur dhunti hyjnore, ngaqë nuk u bindet ligjeve që ka krijuar njeriu mbi tokë, këto pesë mijë vitet e fundit.



Për t'iu shmangur filozofimeve, po i përgjigjem sa më thjesht pyetjes suaj, duke përkthyer ditën time të punës. Ajo është "ditë" e kalendarit tjetër, pra, e pandryshueshme, e njëlojtë, siç ka qenë dje nën diktaturën komuniste, sot, në liri, në Tiranë, në Paris ose në një fshat holandez. Ndaj po përdor kohën e tashme, ashtu si kursantët, kur u kërkohet nga profesori të përkthojnë të dielën e tyre të fundit.

Çohem, zakonisht, aty rreth orës nëntë. Pas ngrënies së mëngjesit, shkoj në studion time. Në qoftë se është dimër, ndez zjarrin në vatër. Ime shoqe më sjell një kafe përpara se të ikë në punë. Unë mbetem vetëm dhe më duhen rreth dhjetë ose pesëmbëdhjetë minuta të futem në kalendarin tim të dytë. Shkruaj ose mendoj atë që duhet të shkru-

aj, skicoj plane, përpiqem të rrok një ndjesi të turbullt, për mua është njëlojtë. Kjo është bota ime, që duket se nuk ka lidhje me atë që ndodh përjashta, me stinën, klimën politike, terrorin, festat. Përpara meje është një kohë tjetër, e thërrmuar si një miell kristali, kohë pa kah, si të thuash, paraprometjane, e cila pret që kahun t'ia jap unë. Edhe hapësira është tjetër, plot "përbindësia gjeografike", siç i quajnë studiuesit befasitë e baladave mesjetare kur, ngjitur me Bjeshkët e Namuna të Shqipërisë, shfaqet Deti i Zi, ndonëse ai është mijëra kilometra larg. Dua apo s'dua, ditë të tëra më mendojnë me të fshehtat e tyre, rrekem t'i kap, por, pikërisht kur duket se u afrohem, ato më shpëtojnë. Mendoj, për shembull, kohën brenda vdekjes. Njëmendësinë e saj (ka apo s'ka kohë brenda vdekjes), ritmin, masën e matjes.

Ndërkaq, në mënyrë të vetvetishme, kontrolloj mjetet, filtrat, veglat e mia, ato që i quaj kështu, ngaqë s'kanë emër në kurrfarë gjuhe. Veç kësaj, më duhet të jem përherë syçelët për gjendjen e gjuhës: a është mjaftueshëm e shkrifët, e ngrohtë, e trajtueshme, e bindur ndaj meje (në çastet e krijimit gjuha i ngjan gruas, që pa kushte, mallëngjyeshëm të jepet ty), apo mos diçka ka humbur nga të gjitha këto dhe, e ngrirë, shpaloset para teje, duke pritur një elektroskok për ta ringjallur. Kjo vetëtimë mund të niset prej trurit tënd, po aq sa nga truri i një gjeniu, që prej shekujsh s'jeton më, por që ta huan ty për një grimë atë trandje hyjnore.

Brumi i vdekjes është gjithmonë aty pranë, por marrëdhëniet e saj me jetën më duken tejet të vështira. Pakti që është bërë dikur midis tyre më ngjan i padrejtë. Qenkësh bërë, siç duket, në një çast ligështimi



të jetës. Kështu, vdekja ka diktuar fjalën e fundit. Më vjen të shpresoj në një rishikim, në një qortim të tij. Nganjëherë më duket se kam pikasur ca shenja, por i kam humbur përsëri. Nganjëherë më duket se mund të kuptoj diçka nga kodi i fshehtë i gjithësisë, nga kujtesa e stinëve, nga vendimi i përbashkët i sektit të gjetheve, për t'u rrëzuar bashkërisht në muajin nëntor, nga tmerri i gropave thellë në oqeanë, që s'janë parë prej asnjë syri të gjallë, nga qendra e diellit dhe, pa dyshim, nga emigrimi i shpirtave.

Kudo janë tabutë dhe ndëshkimet për shkeljet e tyre, dhe afatet që më janë dhënë në letrat e mia, dhe kufijtë, dhe pengesat, dhe vultat, që s'më lënë të shkoj më tej. Mbretëritë plot të fshehta janë përbri. Vetëm njëra prej tyre, ajo e brerjes së ndërjegjes, ka aq shumë porta, por askush s'të lë të afroresh. E mallkoj kufizimin tim si njeri, që s'më lë të kapërcej më tutje. Tërheqja e tokës është aq mizore, saqë më vjen habi që pikërisht tokën e kemi lavdëruar aq shumë

në poemat tona.

Këto e të tjera si këto vërtiten pambarimisht në trurin tim. Kam kujtuar se u kam dhënë lirinë fjalëve të gjuhës, se gjuha është aty përpara meje si një shtet i përmbytur, që pret që unë ta rindërtoj nga e para. Mirëpo, kur shikoj se ç'ka kaluar në libër nga gjithë ky rrëmet, kur shikoj rreshtat që kam shkruar, ata rreshta të tkurrur, të tharë si fosile, e kuptoj se ky është një ndër kufizimet më tragjike dhe dua s'dua pajtohem me fatin, domethënë me mendimin se, ndonëse shumica e asaj që fryn në trurin e shkrimtarit është e dënueshme të shkojë dëm, prapëseprapë ajo që mbetet hyn në stolitë e botës.

Ora po i afrohet mesditës dhe miqtë e mi e dinë se mund të telefonojnë për të pirë bashkë një kafe. Me kryet ende në re, nisem për në kafene. Janë dy kafene ku mblidhemi zakonisht, njëra dyzet hapa larg shtëpisë sime, në hotel "Tirana", tjetra, pak më larg, në hotel "Dajti". Të dyja janë të kribura



Herë pas here shfletoj veprat që kam shkruar në atë kohë, për të parë se ç'ndikim ka pasur terrori në to. "Krushqit janë të ngrirë", "Dosja H.", "Qorrfermani", pjesë të "Koncertit" dhe sidomos "Hija". Sa më shumë diktatura egërsohej, aq më fort ato egërsoheshin, gjithashtu. Duken sipër tyre gërvishtjet e kthetrave të përbindështit. Por ato janë sipër zhguallit të hekurt. Ja, për shembull, "Hija". Si një mbrojtje e parë, në rast bastisjeje të befasishme nga Sigurimi, në faqen e parë është shkruar: Siegfried Lenz, "Hija", përkthyer nga Ismail Kadare.

Ishte një mbrojtje e dobët, tejet e brishtë, e llogaritur për kontrollin në aeroport, gjatë nxjerrjes së dorëshkrimit jashtë shtetit. Kështu, pra, ishte llogaritur kjo mbrojtje për njëzet-tridhjetë minutat e pritjes së avionit. Dhe ashtu ndodhi, pak a shumë, vërtet, më 1987, kur me dorëshkrimin në çantë kapërceva doganën. E besuan që ishte një përkthim i Lenz-it dhe nuk ma mbajtën!

Më 1982, në Oslo të Norvegjisë, gjatë një darke të gëzueshme shkrimtarësh, qëllova në një tryezë me Siegfried Lenz-in. Ia tregova ç'kisha bërë dhe, pasi qeshëm një copë herë, ai më tha t'ia tregoj përsëri, dhe në fytyrën e tij fisnike dukej kënaqësia e thellë, kënaqësia e pafund e kolegut që, në një çast të vështirë të jetës sime, në atë skëterrë ku isha, si një shpirt i ardhur nga larg, që të jep një mjet magjik mbrojtjeje, më kishte huajtur emrin e vet gjerman.

S'arrin të bësh muze për diçka që s'ka ikur, S- thuhet diku nëpër romanin e porsa dalë, "Kohëstrehim", i shkrimtarit bullgar Georgi Gospodinov dhe unë e ndjej fort këtë sentencë, mbase nga që jam lexues shqiptar, ballkanas si dhe autori i romanit, fqinjë që ngjasojmë në fatin historik, gatuajmë dhe njëllor, mund të thuhej në ndonjë katedër, por pësuam dhe atë që vuajti e gjithë Europa Lindore në shekullin XX, të njëjtin sistem komunist, pavarësisht se cila diktaturë ishte më e egër dhe ku tranzicioni është më i vështirë e i pambaruar ende.

Megjithatë jeta mbrapsht është futur në të shkuarën e saj si në një muze, në fakt në një klinikë terapie me psikologun, me të tashmen e braktisur vetë, madje me referendum dhe kështu spitali është zmadhuar sa vendi, sa vendet, ka vazhduar sa i gjithë kontinenti.

Po pra, kjo ndodh në romanin e çuditshëm duke nënkuptuar dhe të bukur, ndërsa po të thosha vetëm i bukur, do ta kisha fjalën dhe për i çuditshëm, në "Kohëstrehim"-in Gospodinov, nga përmbajtja e të cilit përftojmë një estetikë të veçantë, shqetësuese, që më vjen ta shkruaj për shumë arsye: est-etikë si një pësim.

Romanin në shqip e botoi "Toena, me përkthimin nga origjinali nga Milena Selimit, e cila bullgarishten e ka dhe gjuhë të nënës, pra ajo i përjeton fjalët ashtu si ndodhitë në vetë të parë, gjendja është edhe jona. Est-etikë...

PERSONAZHI KOHË

Një roman fantastik, ndjehet si i tillë, kur është dhe realist dhe ndjehet si i tillë, ndërkaq fantastikja shkon aq larg sa mbërrin deri tek vetja, te tjetri dhe kolektiviteti popull, ku personazh qendror është koha, - e padukshme si protagonistët në ca vepra të asisojshme, se edhe koha është e padukshme në vetevetë, mund të thoshim. Por jo. Koha e Gospodinovit në romanin e tij është më reale se realiteti, e konkretizuar, mund ta zgjedhësh e të strehohesh në të.

Pamatshmëria relative ajnshtajniane e saj nuk përbën ndonjë torture mentale. S'janë datat, as emrat e ditëve, muajt, dekadat, meteorologjitet, buletinet e lajmeve, oraret e trenave, të aeroportëve, të takimeve të dashurisë, atentateve, vitet, Lufta e Parë Botërore, e Dyta, Rënia e Trojës, e perandorisë komuniste, datëlindjet, të mbështjellë dhe me mjegull harrese, datëvdekjet, kur ka dhe kujtesë e ringjallje, epokë para dhe pas Krishtit, librat e historisë, shekujt, gjeneratat, mijëvjeçarët, çasti që i shtohet çastit duke e zëvendësuar, pra duke e bërë të pamposhtur, etj, të cilat të gjitha e shenjojnë kohën, e dëshmojnë atë, por s'janë vetë koha. Të paktën te Gospodinovi siç më duket mua.

Koha është ajo që është brenda nesh, pastaj dhe ne jemi brenda kohës, si në një spital pa mure, ngatërrueshëm dhe me një muze, prapë pa mure, që e zgjedhim si romanin, ku vendosim të jemi, jo vetëm si lexues, por dhe si paciente apo dhe artefakte, pavarësisht jetës, që edhe ndodh të jetë jashtë nesh.

SA MË PAK KUJTESË, AQ MË SHUMË E SHKUAR:

Ndërkaq ajo që rrëfëhet në "Kohëstrehim" është distopike, tronditja që shkaktohet prej saj është fare e qetë, bota është e pushtuar nga e kaluara e vet, pra jo nga e panjohura dhe nëse ka rutinë, traditë, absurd, moskuptim deri edhe dhunime, paqe, përndjekje, dashuri, braktisje, Realizëm Socialist, est-etikë, etj, tashmë janë të bëra nga vetë ne, i dimë, s'na trembim prandaj dhe kohën po duam ta mbushim me përsëritjen e vetes. Është më e lehtë rrojtja, jo jeta.

E shkuara, thuhet në roman "Kalonte nga njeriu tek njeriu si epidemi, si murtaja

- Rreth romanit "Kohëstrehim" të Georgi Gospodinov, est-etika e tij -

TË GJALLË SI NË NJË MUZE TË SË SHKUARËS, NË KLINIKËN PA TË TASHME ...

Nga Visar Zhiti

e Justinianit, apo si gripi spanjoll... Njerëzit, thjesht rrëzoheshin rrugëve. Mund të infektoshesh nga gjithçka, mjaft që dikush të të përshëndeste dhe në mbrëmje ishe i vdekur...

Tronditëse sa më s'ka! Të keshë frikë nga përshëndetjet, se bashkë me tjetrin të ka përshëndetur dhe vdekja.

Romani nis me një llogari, e ku ka pa llogari, tepër të largët, por dhe e afërta është shumë larg, se kur është krijuar saktësisht Toka dhe kur filloi koha. Koha e pafund, që na i dhanë me racione si bukën, si ushqimet.

Dhe rrëfimtari, ai mban emrin dhe mbiemrin e shkrimtarit G. G. - autorit të romanit "Kohëstrehim" dhe ka po atë datëlindje, koincidencë domethënëse, romanore, takohet me një "endacak në kohë", enigmatik, - po thonë kritikët, - Gaustinin, i cili është ndjekës a pasionant a i dhënë, i çmendur, përfitues, shkencëtar i prapë i rrugëve të kryera të shekullit të njëzetë, e ka kuptuar ai përdor si një vazhdim me kthim prapa.

Bëhemi të gjithë hapa pas hapi pelegrinë në kohë, mërgimtarë nëpër epoka, dekada, vite të caktura, ku dhe kishim ngecur, me

këmbën si të kapur në lak, çalon kujtesa, harrimi, bisedat...

Në të ardhmen s'mund të shkosh, duhet të vijë ajo, dhe kur vjen. s'është më e ardhme, të tashmen dimë ta bëjmë si rutinë, si detyrat e caktuara, befasitë e saj na gjejnë të papërgatitur dhe shkojmë në kohëstrehimin tonë, në të shkuarën, në vitin që e zgjedhim, ku jemi ndjerë mirë, ku kemi rrokullisur përvojën, sigurinë, që na u bë zakon dhe ruajmë një traditë est-etike, ku janë mundur, psh, nacionalistët, por fitimtarët duke i shpërbyer ata me grotesk. Të kaluarën dimë ta rijetojmë.

Dhe kështu në një ngrehinë në Zyrih, Gaustin hap të parën «klinikën të së kaluarës», një institucion që ofron një trajtim të specializuar për të sëmurët nga Alzheimer, pra e mbush me harrimtarë: çdo kat i pallatit i përket një pjese të së kaluarës dhe është pajisur me atë mobilim e shije e deri edhe në llojin e kopsave të këmishës, me aromat e asaj kohe, që në tërësinë e tyre riprodhojnë mendësinë e caktuar të asaj jetese, vetë atë jetesë, refuzojnë të tashmen, duke u mundësuar pacientëve shpërnguljen pas në kohë për të shbllokuar atë që ka



mbetur në kujtesën e dëmtuar.

Rreziku bëhet i rrezikshëm gjeneralisht kur ideja e Gaustinit përvetësohet nga politika dhe bosët e saj lemerisës. Menjëherë vende të tëra duan të shpërbejnë idenë e kësaj klinike. Në të gjithë Evropën partitë politike përurojnë me referendume epoka të ndryshme të historisë së tyre kombëtare, dekada apo vite, ku janë ndjerë të begatë apo të sigurtë a të lavdishëm apo më pak të kërcënuar, të pagoditur dhe aq nga lufta, kur kishin për të ngrënë, muzikë apo ëndërr.

Dhe nis kthesa, kthimi mbrapsht, ku nuk mungon humori i sharlatanshëm: *Kryeministri i një shteti juglindor gjithashtu veshi poture me shirita, brez të kuq dhe vuri në kokë një kësulë leshdredhur, kush e di pse, e zburuar më kokoshka. Ministri e Turizmit veshi një sarafan të kuq, të rëndë dhe këmishë të qëndisur mëngë-gjerë.*

Est-etika. Imazhi i njohur yni, grotesk provincial. E di apo e ka imagjinuar shkrimtari fqinjë. Rekuizita për të shkuar në të shkuarën nis nga lart poshtë. Apo ata lart e marrin nga poshtë? E sjell mendësia kështu apo mendësia e sjell si veprim?

Dhe një popull vepron si një njeri i së shkuarës. Atdheu i gjithë. Kontinenti i pamasë.

"Europa, e cila mendonte se, pas disa humbesh të rënda të arsyes gjatë shekullit XX-të, kishte fituar një rezistencë të plotë kundrejt obsesioneve të caktuara, mërzi kombëtare, etj, në të vërtetë ishte ndër të parat që u dorëzua."

Një fitore plebishitare. Pa një zhgënjim general dhe... këtu ndjehet si llava e një vullkani të pashpërthyer thirrja e fshehtë për kujdesin nga e kaluara, shpëtimin ndaj saj.

PËR SA KOHË KUJTON, MBAN MËNJANË TË KALUARËN

Romani "Kohëstrehim" është mirëpritur në gjuhë të ndryshme të botës, ndërsa në gazeta të mëdha e revista ka patur mjaft reviews e mendim kritik vlerësues, duke e parë dhe si një sensacion ndërkombëtar të autorit të vlerësuar me çmime të larta.

Romani ka një të vërtetë të madhe ose alarmin që ajo e vërtetë të mos bëhet e vërtetë më.

Shumë njerëz të shëndetshëm mendërisht, - është vënë re, - e kërkojnë këtë klinikë për të shpëtuar nga ngërçi i jetës së tyre të përditshme dhe aluvionet e së kaluarës mbulojnë të tashmen me një si shkëlqim zyrtan, dëshpërueshëm, madje me një farë lehtësimi dhe atë humorin e mençur.

Vazhdon narracioni, vetë klinika është narrative, vazhdojnë suksesshëm terapisti fantast Gaustin, me ndihmësin, narratorin hokatar të pikëlluar, Gospodinov, i cili, e di, e përjetoi komunizmin, u rrit me fundin e tij, në gonglën e njes ku e shkuara lidhet me të tashmen.



Në këtë çast, po punoj me një roman rreth jetës së Krishtit. Në këtë libër, Krishtin e shoh si një tip *hippi*, një tip revolucionari të hershëm. Mendoj se është kureshtar fakti që ai ishte marangoz dhe po ashtu, fakti që gjatë gjithë jetës punoi me copa druri. Kur i kishte ardhur koha për të vdekur, kur pa atë copë druri, patjetër që duhet të ketë menduar diçka. Tani po punoj me një gjuhë për librin, diçka si gjuha nadsat te *Portokall Mekanik*, duke përdorur një shkrim mes dy gjuhëve, në këtë rast anglisht dhe hebraisht.

Në një farë mënyre, kjo është nxjerrë nga çështja Manson. Kam diçka neurotike rreth asaj lloj çmendurie. Është e tmerrshme: e keqja, kaosi, shumëllojshmëria e tij. Nëse ka diçka që më bën ta dëshiroj vdekjen, që sjell dëshirën për të vdekur, është kjo. Shqetësohem gjatë gjithë kohës. Shqetësohem për time shoqe dhe për tim bir në New York. Mes të droguarve dhe psikopatëve të lirë nëpër rrugë, vështirë të jetë e sigurt për të dalë nga shtëpia. Të rinjtë flasin vazhdimisht rreth të qenit “në harmoni me realitetin”, por pyes veten me çfarë janë *realisht* në harmoni? Nuk jam i sigurt nëse ndjekësit fanatikë të Jezusit apo të rinjtë e përfshirë në këtë lloj gjëje janë të lidhur në fakt me diçka përtej Jezusit, ndoshta me djallin. Ti e di se përgjatë historisë, në emër të kishës njerëzit kanë bërë gjëra të këqija. Reformimi, Gjyqi ndaj Shtrigave të Salemit... përgjatë gjithë historisë, njerëzit janë keqdrejtuar nga shfaqje të Zotit. Kjo më bën të zgjedh thjeshtësinë. Ka vërtetë shumë shumëllojshmëri. E Keqja përreth nesh është e frikshme dhe nuk ka siguri të merresh me të. Vetëm artisti mund të merret me të, pasi ai mund ta bëjë këtë më objektivist. Dhe ka të ngjarë që kjo të mos jetë tërësisht e sigurt.

Ngado të shohim ka konflikt. Në kampuse, në televizor, në rrugë. Zoti e di, New York City, qyteti ku jetoj, është qyteti më i rrezikshëm në botë. [...] Konflikti është kudo. Është shekulli i njëzetë dhe jemi të rrethuar me konflikt. Si Jini dhe Jangu, i nxehti dhe i ftohti, Zoti dhe Djalli: gjithçka është konflikt. Ky është universi dhe pa konflikt, nuk kemi fare jetë. Por termat e konfliktit janë të pasigurt. Për shembull, e Drejta dhe e Gabuara: çfarë duan të thonë këto terma? E kam fjalën *realisht*, çfarë është absolutisht e Drejtë dhe çfarë është absolutisht e Gabuar? Mund të ulemi dhe të bëjmë një listë. Çfarë do të thojë se është e Gabuara? Do të thojë se është e Gabuar të urresh? Ndoshta. Por po në kohë luftrash? Në kohë luftrash, është e Drejtë t'i urrejmë armiqtë tanë. Është e Drejtë t'i vrasim ata. Fjalët e Drejtë dhe e Gabuar, në vetvete, nuk duan të thonë asgjë. Rreth tyre ka aromë dezinfektanti të oborrit të një rajoni policie.

Dhe e Keqja. Disa njerëz duket se kanë një dëshirë të pashpjegueshme të bëjnë keq. Po pse? Mund ta dimë çfarë është e keqja? Cilat janë shenjat e saj? Dëshira për të shkatërruar është e keqe – e pashpjegueshme, papërmbajtshmërisht destruktive. Por as kjo nuk është kategorike, apo jo? Shumica e historisë është shkruar rreth shkatërrimit, jo rreth krijimit. Të dhëna janë mbajtur për luftëra, për rënie qytetërimesh, për vrasje dhe vdekje, për njerëz si Aleksandri i

Në *Panairin e Librit të këtij viti*, shtëpia botuese “Onufri” do të sjellë për herë të parë në gjuhën shqipe romanin “Portokall mekanik” të Anthony Burgess, përkthyer nga Durim Taçi. Në vijim, një pjesë nga një intervistë e pabotuar me autorin ku flitet për këtë roman dhe krijimtarinë e tij në përgjithësi.

BOTOHET PËR HERË TË PARË NË SHQIP ROMANI “PORTOKALL MEKANIK” I ANTHONY BURGESS

Madh, Napoleoni, Hitleri dhe të tjerë që ndërtuan perandori jashtëzakonisht shumë të mëdha mbi aftësinë e tyre për të shkatërruar. Por në njëfarë mënyre, shkatërrimi është një mjet krijimi. Kur një vagabond godet përlesh një kabinë telefoni ose gërvisht emrin e tij në anën e një tramvaji, ai është duke lënë shenjën e vet. Ai, e di ose jo, po përpqet të tregojë se ekziston dhe se ka aftësinë t'i ndryshojë gjërat. Dhuna shkatërruese është një mënyrë për të thënë “Shiko, jam këtu”. Kjo është mënyra e thjeshtë. Ky është krijimi negativ. Krijimi pozitiv

është shumë më i vështirë – kërkon më shumë durim dhe talent. Sigurisht, këto të rinj me kapuç të zezë nuk kanë durim. Është shumë më e thjeshtë të shkatërrosh sesa të marrësh një bllok guri dhe dalëngadalë e me kujdes të nxjerrësh prej tij një imazh: kjo kërkon një artist. Dhuna është shumë më e shpejtë dhe për kapuçezet e banditët, besoj se dhuna është më shpërblyese pasi është më e lirë. Nuk ka kufizim dhe kontroll. Po ashtu, është kjo shtysë lirie në të.

Romani im *Enderby* është për një

poet të neveritshëm dhe të shëndoshë. Ai gromësin, pi shumë, jeton në tualet, poezitë i shkruan mbi banjë, masturbohet, i shmang të gjitha format e detyrimeve dhe nuk është i mirë me gratë. Enderby është i lirë. Besoj se kjo është ajo çfarë më pëlqen tek ai. [...] Por, sikurse e sheh, kur një personazh apo njeri është shumë i lirë, atëherë ai sfidon shoqërinë. Tani, një ndër premisat bazë të shoqërisë është se askush nuk ka shumë, shumë liri. Libri i B. F. Skinner *Përtej Lirisë dhe Dinjitetit* i cili, aksidentalisht doli në të njëjtën kohë me filmin e *Portokall mekanik*, thekson se ne duhet të heqim dorë nga të drejta dhe privilegje të caktuara kështu që të mos e imponojmë veten përmbi komshinjtë. Duhet të ushtrojmë kontrollin; duhet të kufizojmë lirinë tonë për hir të shoqërisë. Kjo do të thotë të heqim dorë nga liria e zgjedhjes. Artisti është një rebel i cili e sfidon lirinë përmes veprës së tij. Ai arratiset në skutën e tij ku pikturon ose shkruan ose bën një skulpturë dhe kështu, ruan identitetin e vet. Mund të ndodh që edhe për kriminelin, dhuna të jetë një shprehje lirie e të njëjtit lloj ose e një lloji të përafërt. Gjithsesi, në kohën kur përdor dhunën, je jashtë kontrollit.

[...]

Dhuna është kaos. Ka një luftë të vazhdueshme mes kaotikes dhe estetikes dhe individi duhet të luftojë për të mbrojtur autoritetin e vet. E vetmja shpresë për të shpëtuar nga ky kaos është të njohësh fuqinë e individit njerëzor. Besoj se jam disi manikeist, por kjo lloj lufte, kjo betejë mes së mirës dhe së keqes, më ka intriguar për një kohë të gjatë. Jam përpjekur të merrem me të në romanin tim *The Wanting Seed*. Ky është një libër që për vite me radhë kam dashur ta shkruaj, por asnjëherë s'munda ta gjej tamam formën e duhur. Më në fund e shkrova, ndonëse akoma nuk është tërësisht një sukses, por ajo çfarë më ka shqetësuar këtu është një luftë mes ideologjive. Në njërin anë ke konceptin Palagian që njeriu, në thelb, është i mirë dhe i aftë për perfeksion nëse lihet i vetëm dhe lejohet të zbulojë rrugën e tij. Në anën tjetër ke konceptin Augustinian që njeriu është i aftë vetëm për të keqen dhe se pa Zotin, shpresa e tij e vetme është vetëshkatërrimi dhe mallkimi i përjetshëm.

[...]

Anatole France ka shkruar një herë një roman të quajtur *La Revolte des Anges* që shpjegon një lloj lufte të përjetshme mes Zotit dhe Djallit. Zoti sundon nga njëra anë mbi fuqitë e së mirës ndërsa djalli, nga ana tjetër ka mbledhur forcat e së keqes. Nuk po them se kjo është domosdoshmërisht e vërtetë, por sigurisht që është një mundësi për t'u marrë parasysh prej nesh. Merr vetë fjalët e Krishtit, “Nuk erdha të bie paqen, por shpatën.”¹ Mund të jem manikeist, por ne duhet të jetojmë me ndasi. Orvatemi për rregull dhe bashkim, por nuk ndodh shpesh që të mund ta pranojmë se ia dalim ta gjejmë atë.

Artisti përballet me detyrën e zbulimit të natyrës së realitetit. Ai nuk është predikues, detyra e tij nuk është të jetë didaktik; ai mund të jetë mësues – të gjithë përpqemi të jemi të tillë; por romancieri është i detyruar të bëjë punën e tij. Ashtu sikurse ka thënë Henry James, detyra e tij është të dramatizojë.

¹ Përkthimi sipas dom Simon Filipajt, Mt. 10:34

PORTOKALL MEKANIK

Përktheu: Durim Taçi



ANTHONY BURGESS

Onufri

Të zbulojë natyrën e realitetit. Duhet ta mbash mend se për poetin, artistin dhe romancierin, natyra e realitetit nuk është e zbuluar nga imazhe që i kalojnë në mendje, por nga fjalë: fjalë që sugjerojnë kuptime të caktuara dhe zbulojnë veprime ashtu sikurse autori i njeh. Por autori nuk mund të vendosë e drejtë apo e gabuar. E gjitha çfarë ai mund të bëjë është të tregojë një lloj "skenari të rremë" nga i cili lexuesi mund të nxjerrë konkluzionet e veta. Autori nuk mundet t'i ndajë skenat në terma të së mirës dhe të së keqes, por diçka ama: e mira nuk është domosdoshmërisht e kundërta e së keqes dhe ka një vlerë të caktuar subjektive të së keqes. Po ashtu, ka një vlerë të caktuar të së mirës e cila shkon përtej kuptimeve të së drejtës dhe së gabuarës: një e mirë që e përjetojmë në një pjesë të bukur muzikore, shija e një molle apo seksi. Pa një njohuri të ekstremeve është e vështirë ose ndoshta e pamundur të njohësh gjësend nga ato çfarë janë në mes. Një burrë apo një grua që s'ka bërë ndonjëherë keq nuk mund të dijë çfarë është e mira.

Është ironike që përherë më lidhin me *Portokall mekanik*. Mes gjithë librave të mi, ky është ai që më pëlqen më pak. E kam shkruar në vitin 1961, një vit pas atij në të cilin supozohej të vdisja dhe ky libër zbulon shumë nga turbullitë e mendjes sime atë kohë. Nuk mendoj se është libri im më i mirë, por në të njëjtën kohë, libri zbulon goxha shumë rreth konfliktit mes së mirës dhe së keqes e po ashtu, rreth kësaj frike të dhunës irracionale. Në shumë mënyra, libri është unë; ajo çfarë shkruajmë është vërtetë shumë ajo çfarë jemi. Dhe libri zbulon një betejë të brendshme me këtë cilësi: të keqen. Jo vetëm të keqen, por rrezikun e përpjekjes për ta korrigjuar atë. Në thelb, jam shumë dyshues në përdorimin e fuqisë për t'i ndryshuar të tjerët.

Portokall mekanik shfaq po ashtu teorinë e lavjerrësit: si ekstremiteti spastron tjetrin. Por në fund të fundit ne, si qenie njerëzore, duhet të arrijmë vetë tek termat e dilemave të së mirës dhe së keqes, së drejtës dhe së gabuarës ose çfarëdo qoftë. Nuk është Zoti ai që do ta bëjë këtë për ne. Unë nuk do t'i marr vendimet e mija duke thënë "Credo in unum deum." Po të ketë një Zot, ai është një Zot mbinjerëzor, i pashqetësuar nga motivet njerëzore. Në ekzistoftë apo jo Zoti, konflikti i së mirës dhe së keqes është i pashmangshëm. Edhe po të mos ketë qenie njerëzore në tokë, parimet e së mirës dhe së keqes do të ekzistojnë. Nuk besoj se pas 2000 vitesh, nëse bota do të vijojë të ekzistojë, ajo do të jetë më pak e keqe ose më pak e mirë. Lufta nuk do të mbarojë asnjëherë. Çdo moment qetësie ndiqet nga një periudhë më e gjatë dhe më shqetësuese shqetësimi. Mund të jetë, ashtu sikurse thuhet, që e keqja është dinamike dhe e mira priret të jetë më statike – me siguri që kështu duket në New York City ku unë jetoj, nejtë – por detyra e individit konkret duhet të jetë që të mirën ta bëjë një forcë më pak statike: ta bëjë atë më dinamike sesa e keqja. Por cila është forca aktive e së mirës? Dashuria. Do të thoja se Dashuria është forca aktive dhe ne duhet të mësojmë si t'i duam gjithë njerëzit dhe gjithë gjërat e tjera. Kjo duket të jetë sfida e shekullit të njëzetë. Por, a e bëjmë dot?



Stanley Kubrick për romanin *Portokall mekanik*

Bazuar në këtë libër, regjizori i njohur Stanley Kubrick realizoi në vitin 1972 filmin me të njëjtin titull i cili u mirëprit në mënyrë të jashtëzakonshme dhe akoma edhe sot shërben si bazë e shkollave kinematografike. Në atë vit, ai u dha një intervistë Philip Strick dhe Penelope Houston e cila u botua në revistën *Sight&Sound*, ku ndër të tjera, pyetet për bashkëpunimin me Burgess në procesin e krijimit të filmit:

S&H: Sa pranë Anthony Burgess ke punuar në adaptimin për ekran të *Portokall mekanike*?

Stanley Kubrick: Nuk kam pasur thujasë asnjë mundësi ta diskutoja romanin me Anthony Burgess. Më telefonoi një mbrëmje kur po kalonte nga Londra dhe patëm një bisedë të shkurtër në telefon. Ishte kryesisht një

shkëmbim kënaqësish. Në anën tjetër, nuk isha veçanërisht i shqetësuar për këtë pasi në një libër aq të shkëlqyeshëm sa *Portokall mekanike* dikush veç po të ishte dembel nuk do të gjente përgjigje për çfarëdo pyetjeje që mund të dilte nga brenda tekstit të vetë romanit. Mendoj se është e arsyeshme të thuhet se, çfarëdo që Burgess ka pasur për të thënë rreth historisë, ishte e thënë në libër.

S&H: Po për kontributin tënd në histori? Duket sikur ke ruajtur stilin dhe strukturën e origjinalit shumë më shumë sesa me pjesën më të madhe të filmave tuaj të mëparshëm, dhe dialogjet janë krejt të njëjtë si ato në roman.



Stanley Kubrick: Kontributi im në histori konsiston në shkrimin e skenarit. Ishte parimisht një çështje përzgjedhjeje dhe redaktimi, paçka se kam krijuar pak ide narrative të nevojshme si dhe

i kam dhënë tjetër formë disa skenave. Megjithatë, në përgjithësi, këto kontribute vetëm sa qartësojnë atë çka tanimë ishte në roman.

Dy fjalë për përkthyesin

Durim Taçi lindi në vitin 1964. Është shkrimtar dhe përkthyes i njohur, ku mes veprave të tij si autor mund të përmendim "Extra Time", "Një prani në ikje", "Nga një derë tjetër" (Fitues i Çmimit Kombëtar të Letërsisë, 2021), "Liqeni në mes të detit" (Fitues i Çmimit Kombëtar Fishta, 2022) dhe këtë vit, do të botohet edhe romani i tij më i ri "Lakimi". Ndërkohë, si përkthyes nga anglishtja dhe italishtja në gjuhën shqipe, mes më shumë se njëzet e pesë librave të përkthyer, ka autorë si Per Petterson, Tom Bollough, Siobhan Parkinson, Adrian Kenny, Karl Ove Knausgaard, Guido Zavanone etj.

Përgatiti dhe përktheu Andreas Dushi



Një Elitis brenda meje dhe rreth meje. Edhe është edhe s'është vegim. Para meje librat e tij që m'i dërgoi kohët e fundit me autografin klasik: "Niko Kacalidha, për zemërsisht, me dashuri, miqësisht, Odiseas Elitis." Dhe patha shkrimin e bukur sikur të puthja mermeret greke. Sikur të puthja dorën e tij. Sikur t'i lutesha një perëndie. Elitohyjnisë. Kështu prej asaj dore path të gjitha perënditë e tjera të grekëve.

Në shtëpinë prindërore në Leshnicën e Sipërme, nën hijen e malit tim hyjnor, gjithmonë zbriste fantazisë sime nëntogeri i mobilizuar që në ditët e para të luftës italo-greke në brezin e zjarrit të malit, Elitis, i hershëm, i ngjeshur, mjekrosh, me uniformën dhe rripin shtrënguar.

Në shtëpinë time në Sarandë, disa metra larg detit, prapë një Elitis tjetër më ka rrethuar dhe sikur më thotë: "Në qytetin ku jeton ti, prej kohësh kam kaluar duke ndjekur italianët këmba-këmbës, netëve të pafundme gjer në Akrokerona. Pikat e gjakut tonë janë ende të njoma nëpër rrugë."

Dhe kërkoj vazhdimisht rrugëve të qytetit tim gjurmët e Odiseas Elitisit. Përballë, më zgjojnë mëngjesive këndesat e Korfuzit. Sipër nga bedenat e kështjellës, Elitis, student i shkollës ushtarake, duke vështruar brigjet tona, përballë. Se mos dallonte Seferisin e madh, më sipër meje, me "gegët dhe toskët".

Një Elitis rreth meje dhe një Elitis brenda meje që dua ta deshifroj.

Para meje, tani: "Kënga heroike...". Nëntogeri që dergjet mbi kapotën e përzhitur në Malet Akrokerona dhe ia shërojnë plagët mëmat tona me të zezat si në tragjeditë e moçme. Qielli i mrrullur. Buka kullon gjak. Shekujt e zinj lehin, me skelete qensh. Gjëmojnë kambanat e kristalta për pashkën e perëndive, himnin e heroizmit dhe rezistencën e lirisë.

"Aksion Esti" dhe "Oi, oi mëma ime", "Oi, oi mëma ime". Klithma e vdekjes që jehon ende humnerave tona. Sinteza liriko-filozofike. Himni i helenizmit dhe i shpirtit helen me diej, male dhe dete. Triptiku i ngjyrave greke të përjetësisë.

Brenda meje Elitis me brigjet gjithëkaltra dhe ullinj të gjithëgjëlber të mbijetesës. Shpirti dhe trupi i bukurisë. Magjitet e përjetshme të poezisë greke. I lindur prej Egjeut, lindi Egjeun. I lindur prej Greqisë, pjell Greqi. Diçka filozofike buron prej damarëve elitiane.

"Aksion Esti" (E denjë është) – një kor polifonik profetik. Elitis dëshmitar i gjallë i historisë nuk psal De Profundis. Liturgjitë kishtarë, psalmet dhe himnet bizantine, elegjitë greke, janë tradita.

"Aksion Esti" gjëmon nga triumfi, shpërthen vitaliteti i pjellshmërisë.

E përndritshme, e ngazëllimit onirik. Me klithmat në kllapi të heronjve që herë çajnë dete dhe herë metamorfozohen në qenie të tjera si në epet homerike. Në thelb është poeti, atdheu dhe vlerat e tij. Me të përgjithshmet: hyjni, male, ishuj, heronj, shenjtorë, pëllumba dhe vajza, kryeengjëj dhe erëra, poetë dhe lule, zëra njëqindvjeçarë dhe statuja të shkëmbinjve. Me të përveçmet: brigjet e Homerit, gjuha greke, fjalë sirenash, Krishti u ngjall, vargu i parë i himnit, lëvdar qoftë. Himara, Delvina, Saranda, Helenat e bardha, Nemesis, dallëndyshja dhe pranvera, zoti kryemjeshër, heronjtë-shenjtorë, ishujt-tempuj. Dhe përmbi të gjitha, drita greke. Dhe tani dhe përherë dhe Aksion Esti. Kjo bota, e vogla, e madhërishmja.

Kjo botë brenda meje. Bukuria dhe magjia që burojnë nga kumbimet, tingujt, bashkëtingëlloret, zanoret dhe shndërrohen në poezi, që sjell adhurimin e natyrës, fiziologjinë, harmoni gjithkund.

Sikur parajsën ta ketë ndërtuar Elitis me modelin e hapësirës së tij. Me një verë të perëndishme në një gjithësi virgjinë si në ditën e parë të gjenezës. Këtu Zoti krijoi botën. "Në fillim drita./ Dhe ora e parë/

Vëllimi poetik "Aksion Esti" nga Odiseas Elitis, përkthyer nga Niko Kacalidha, Onufri

NJË ELITIS BRENDA MEJE...

(Vegim me Elitohyjni)

Ese nga Niko Kacalidha

ku buzët ende në baltë/ shijojnë sendet e botës".

Drita e pafundme është jeta e pasosur. Drita kalon nga Elitis dhe brenda nesh nën metamorfozën e shpirtit njerëzor. Bën fotosintezen poetike të diellit dhe lind e kaltra e thellë e qiellit dhe e detit.

Transparenca është ekuilibri i botës. Elitis edhe në çastin më kritik nuk e nxin botën. Erosi dhe dashuria është burim i dritës dhe i atdheut. Këtu parajsja që shtyn ferrin. Këtu Zoti, kryemjeshër. Këtu Homeri, kryelirari.

Elitis është figuracion i dukshëm dhe i padukshëm. E ndritshmja dhe e pandritshmja. Është meditacion i vargamleve, jehonë greke, tragjike, bizantine, demotike. Elitis është realiteti dhe s'është. Surrealizmi i tij pjell figura kinematografike. Elitis pjell figura dhe jo fjalë që zvarrisin pas tyre fjalë të tjera rimash shterpe. Në një të tillë moral beson Elitis dhe këtë moral poetik pranon në botë. Kjo poezi i ka me vete të gjitha llojet klasike. Veçse çelësi i parë i brezit të tij është i lirës. Elitis është liriku i madh i mbyllur midis maleve. I mbyllur midis deteve. Mos është vallë murg a eremit? Jo. Është kryemjeshër.

Dhe natyra virgjërore, ndrojtur hap gjinj të saj, për të rrefyer të fshehtat e veta.

Kllapi, përçartje? Se mos ka ligjësi të prera si me thikë natyra? Tani, në qoftë se do të shkëlqejë, shkëlqen. Tani, do që të vrenjitet, vrenjitet.

Brenda meje në altar "Aksion Esti", me arkitekturën e tij si një Partenon që ka pak e nga të gjitha. Shtylla dhe ballëzina, shkallë dhe statuja. Simetri e artë në llojin e vet. Prerja e artë aristoteliane e sendeve. Poezi, muzikë, lexime të hedhura atje, psalme, ode, fjalë të prera, ligjërime.

Në kohën e Babilonisë zoti e privilegjoi Elitisin, gjuhën ia dha greke. Kjo është nga thesaret e tij të para.

Tek Elitis çdo dukuri merr vlera të reja, mbështjellë mes dy fjalëve: gjuhësore dhe poetike.

Gjeneza. Vuajtjet. Gloriozja. Janë tri shtylla që mbajnë gjithësinë elitiane. Elitis është një gjithësi e kompletuar, adhuron një hyjni, që duhet të quhet Elitohyjni. Unë i besoj Elitohyjnisë së metaforës, që shkatërron aritmetikën e thjeshtëzimeve vanitoze.

Këtu, fantazi onirike. Kozmogoni. Jetë e vdekje. Dashuri dhe diell.

Elitis është edhe plak filozof, edhe fëmijë i fantazisë së "Shegës së çmendur", edhe mrekulli-vullkan i ishujve, zog motak dhe delfin vajzëror.

Kur lexon Elitisin, të duket i pambarueshëm. Kur e rilesson, e gjen ndryshe nga hera e parë dhe prapë nuk e ke konsumuar. Rilesson dhe optikë tjetër shfaqet. Ky karrem i Elitohyjnisë është tërheqje si e plakut të Heminguejt. Të tërheq gjithmonë pranë tij. Çdo fjalë është varg. Çdo varg sintezë. Çdo sintezë akullnajë. Është mal që nuk pushtohet lehtë. Nuk mund të ngjitesh nga të njëjtat shtigje që kaloi Elitis, sepse ai nuk mori shtigjet e të tjerëve. Të vështirat zgjedhi.

Elitis e merr fjalën si mermerin dhe e gdhend në të katër dimensionet. Kështu fjala merr dimensione të reja dhe vlera. (Kush mund të mendonte se do të hynin edhe mushkarët pranë mermereve në poezinë greke?)

Fjala e Elitisit është e peshuar, e latuar, e bukur, muzikore, e ngrohur në gjirin e tij, e sprovuar në acar dhe në diell. Ajo për-ngjan me kristalet e apokalipsit, lëbyr, në gjuhën e çuditshme të mermerit. Madje, edhe i famshmi "Aksion Esti" bëhet më profetik dhe nga psalmet kishtarë.

Elitis është njohës i maleve dhe i deteve, po si hamall ngre male të reja. Krijon të tjera dete. Rrëzon kufijtë tradicionalë midis tyre.

Kjo bota e Elitohyjnisë. E ekzistencës dhe mozekzistencës.

E tokësore dhe fantastike.

Elitis nuk është imitues, është krijues i botës së tij elitiane që pjell hapësirën dhe kohën, njërin mbi tjetrin. Bota ideale në Polisin e tij pranë të bashkëbisedojnë perëndi dhe shenjtorë, filozofë dhe engjëj, shëgët dhe dritat. Vargu i Elitisit është i vendosur i milimetruar në faqen e bardhë të vegimeve. Në vijën e tij vizuale. Jo në kuptimin klasik. Është i krasitur si me gërshtëren diellore të Egjeut, është alkimia e simetrisë së vargjeve e të ngjyrave.

Greqia është perëndia e Odiseas Elitisit. Kodet e tij poetike janë si perikope germash të moçme. Bukuri, Homer, Odiseas (Elitis). Ç'kohincidence, që të tria fillojnë me omikronin e lashtë kapital grek.

Bukuria nën botën dhe është mëkat të nxish bukurinë.

Skenografia e gjithë peizazhit detar grek është e Odiseas Elitisit.

Rigatimi i miteve në rërat e Homerit është i Odiseas Elitisit. Vallet e bletëve, kuintesenca e kësaj bote, sinteza e melodive të puhizës dhe erës lindore me shkëlqimin dhe klithmat e vetëtimës, të Odiseas Elitisit janë. Paraqitja estetike e vargjeve si në shkallët e amfiteatrove të lashtë përsëri e Elitisit është. Bukuria e Odiseas Elitisit është një tempull i bukur së brendshmi, i bukur edhe nga jashtë, i di të çarat e mureve, plagët dhe hedh shumë dritë-melhem të grekëve për t'i shëruar. Si me tërëfilin detar që bën të vdekshmit të pavdekshëm.

Ekonomia e figurës së tij është tek atomi që dalëngadalë bën mermerin. Dhe mermeri ngre në këmbë tempullin me dritaret e fshehta si kaleidoskopë, që të të nxjerrin në botën e Odiseas Elitisit.

Shumë fjalë nuk m'i shpjeguan fjalorët akademike. Ishte drita e "Ungjillit" tënd që ra brenda meje. Kështu, surrealisht, kërcenin dhe bëheshin një botët dhe në "Ungjillin" e përrallave të gjyshe sime.

Druri elitian është fiziologjik. Nuk është jashtëtokësor. Ai hodhi rrënjë në tokë pjellore dhe u ujit në Olimp me nektarin e perëndive. Dhe nëse ngjitet dhe gjethëron, në monologun dodonik, nuk është hermetik dhe i pakuptueshëm. Me perënditë e lashta bisedon dhe me vdekatarët e botës. Kështu janë profecitë e tij. Edhe në Dodonë, profecitë thikë me dy presa ishin. Si t'i kuptojë? Atje ishte dhe vlera e tyre.

Aksion Esti! E denjë vlera e tyre!

Sarandë, 15 janar 1995

ODISEAS ELITIS

Aksion Esti



Shqipëroi nga origjinali:
NIKO KACALIDHA

OnufriPoezi

Atdhe m'u bënë idetë

Atdhe m'u bënë idetë që i ngroh ëmbël në kllloçkë
me kurmin e mërdhirë, në folenë më të lartë
të kavakut dimëror, të zhveshur, pilirak –
si një klithmë me penel mes trishtimit fusharak.

Idetë m'u bënë Atdhe, i dehur me vetmi në folenë më të lartë, ku nuk ngjitet asnjëri,
ku i kaltri gjak venoz mezi shtyhet pikë-pikë,
ku dhe kllloçka e pangrohur në fole, ka rrezik
mos me çelë zogj të gjallë. Për një stinë. Për një vit.
Për një jetë që përpëlitet me Atdheun-kockë në fyt.

2024

Bibliotekë ekzili

Bibliotekë ekzili, e një gjuhe që nuk e njoh.
Raftë të mbushuna me libra të blemë lirë,
të falun, të qitun jashtë shtëpive.

U bana strehë në këto raftë, mes të cilëve tash,
netëve t'pagjuma, endem i përhumbun si një shaman në kërkim të shpirtave;
u kall vështrimin pyetës shpinoreve, titujve,
me një dilemë të pezullt në mendje.
Po librat saorë ngjishen mbas njeni-tjetrit në raftë –
japin me kuptue: "Nuk do të bahemi kurrë të tutë!"

Duhet kohë, them. Shmang vështrimin.
Duhet kohë,
shestoj me vete, me folë, me u marrë vesh,
ashtu siç bajnë burrat me gratë e hueja,
të pashmangshme.
Më sëmbon sakaq ekzistenca e braktisun e bibliotekës sime në Tiranë,
ndjesia ime, si e një anijeje të ankorueme me spirancë në brigje të sigurta, të kuqërremta,
të veshuna me një vjeshtë të begatë dijesh me fruta t'pamorta.

A s'asht njëmend kështu, o të ngjashmit e mi?
Qiejt tanë janë biblioteka.

Do kisha dashtë me u shkimbë në prehnin e Sofisë sime qiellore në Tiranë, mbuluem me vëllime të trasha klasike, enciklopedi, fashikuj poezish e traktate, midis një kuvendimi
joshës, pa mbarim, tue u fikë kadalë si kandili në përpëlitjen e mbrame.

Por tash më duhet me shpikë një vete tjetër,
një tjetër jetë, deri kur ta zbus këtë grue të egër,
të panjohun e të ftohtë, që fati ma shtiu për short.

Bex, 1 nëntor 2020

Në do diç me këndue

Në do diç me këndue, kënaqu veç me motivin,
por mos shpresu që kanga jote t'ketë dhe fjalë...
Ka me na ardhë shurdhimi për dore me dimnin,
me na kredhë në guvën tonë dalkadalë...

Kështu, yllit të bjerrun zen i ftofet magma,

Vëllim i ri poetik, *Onufri*

AGRONTUFA

Njeriu buzë lumit

gjer akulli t'ia ketë ngri zemrën e zjarrtë...
Kështu shtresë mbas shtrese, ndën kafkull,
dhe fjala
vdes mes përpëlitjesh në vnerin e artë.

Na mbetet me ngrofë një ngushëllim të mbramë,
kangë tjetër me provue me kordat e mpime.
Muza zbret vërtik e ngulet si kamë në zemrat e fjalëve, mes çerdhes së ngrime.

2024

Si një grusht farërash

Jemi si një grusht farërash të thata lëshuar në erë.

Trillet e saj na bartin, na shkapetin në këtë tokë të marrtë. Dikush kalbet në humus; dikush kapet me rrënjë në shkëmbinj.

Çdo detaj tjetër është drama, drama e vërtetë,

ndonëse e papërfillshme për shortin e paracaktuar.

2022

Njeriu buzë lumit

Njeriu buzë lumit plaket ma shpejt.
Nuk e përballon mësimin e pandërpreme të rrjedhës së pandalë,
as ligjësinë e saj;
bahet Pan i Vrrijeve, me rrudha e çaçkë tullace,
përndryshe – filozof.

Asht një garë shkatërruese me u përballë çdo grimëkohë me rrjedhën,
me imazhet mendore "me rrjedhë a me qenë",
që lumi pavetëdijshëm t'i shuen si gurë gëlqerorë
tinëzishit ndër zgavra.

Njeriu buzë lumit e mblehd rrjedhën vorbull ndër vedi,

bahet turbinë e shpërthen në dritë.

Lumi rrjedh pa shestim,
e mbyt turrin ngutanak në det.

Por ti, së paku, mundesh me mbetë veç një gjurmë drite, deri në fikje,
në rrjedhën e pamort.

2022

Në cilën anë?

Tan natën e lume rrafshulta shfryu borë.
Agsholi i kjarueme me qiej kristalinë na gjeti buzë lumit. Prej aty,
me sy t'paarmatosun,
nuk qe zor me dallue matanë lumit
legjionet e kampit anmik,
t'rreshtuem n'centurione.

O ti, fli e qiellit,
rrafshultë e përborun,
na e beko gjakun e derdhun me sakica për Patrie!

Me shëjin për sulm,
lumi ka me rrjedhë dhe, anëpëranë,
bora ka me u ndezë prush,
e gatshme për penelin e piktorit.

Por në bunacën para ploje dëgjohen shfletimet e blloqeve,
kërcitja e shpalosjes së hartave, cijatja metalike e burmave të kamerave, fotoaparateve,
provat e lidhjes direkte në mikrofon me studiot televizive
dhe, mbi të tana, shtrëngimi nervoz i rripave të pajimeve, çantave,
ngjeshjet dhe zhveshjet e shpatave prej milli,
me sy të fiksuem për qiell.

Vonohet shëji i msymjes.
Kush ka me sulmue i pari?
Dy fajkonj përleshën në qiellin mbi lumë, midis dy ushtrive:
sytë e dy palëve janë mbërthye mbi ta dhe fikthet në grykat tona tashmë janë pistonë të çmendun ankthi:

Në cilën anë ka me ra shyt përdhe fajkoi i vdekun?

Janar 2022

A dëshmon shkretëtira?

Për karvanin e bardhë që u tret pa klithmë në ranë të nxehtë dëshpërimi
a dëshmon shkretëtira,
i regjistron jehonat?

Shkretëtira ka një ndërgjegje të vetën,
të paplasaritun,
ku pandehmat tona bajnë rikoshet.

Herëdokur ajo na dërgon shenjë të fshehtë me ndenjtë sus – mandej, pak e fije,
nis bashkpunimi i heshtun,
nështrimi,
dorëzimi,
shndërrimi në landë të përsosun të saj.

Por, për çdo shkamb e zall,
për çdo sukë e kum,
ngrihet prej agu në muzg një si kangë,
një si murmurimë,
një si thirravaj
i pakapshëm për veshin e gjallë.

2022



Më datë 25 tetor 2024, Biblioteka e Qytetit të Shkodrës "Marin Barleti" vlerësoi me çmimin "Koliqi" dy shkrimtarë, Ridvan Dibrën dhe Andreas Dushin, autorë të shtëpisë botuese "Onufri".

Ridvan Dibra me motivacionin "Për kontributin e çmuar jetësor në krijimin dhe receptimin e letërsisë shqipe të pas viteve '90 si shkrimtari që ndau periudhat, duke sugjeruar një letërsi tjetër, të shkëputur përfundimisht nga ideologjitë dhe kurthet njëkahëshe të totalitarizmit, nëpërmjet një mendësie të re artistike, estetike dhe të problematikave, me në thelb idenë e lirisë dhe kufijve të parrokshëm të saj."

Andreas Dushi me motivacionin: "Për kontributin e veçantë në krijimin dhe receptimin e letërsisë së re shqipe nëpërmjet elaborimit në nivel të lartë estetik të temave të absurdit si dhe për qasjen ndaj realitetit të sotëm dhe atij të shkuar duke ndërthurur me talent dhe autenticitet epiken me postmodernen."



Fragment nga romani "Lakimi", Botimet *Living*

DURIM TAÇI

Lakimi

"Mëritën që ia dalim të kënaqemi kaq Mgjatë brenda njeri-tjetrit, duhet t'ia njohim, mbase, atij dialogu të heshtur vështrimesh. Siç duket, e kemi kuptuar se dashuria, - ky udhëtim vetmitar në dy, - fillon dhe mbaron tek sytë, si leximi"

Elira pati një frikë absurde se këtë mendim që formuloi befasi me vete dhe, në një formë kaq letrareske, do ta gjente të shprehur nga Roberto në mesazhin e radhës. Zgjati dorën djathtas për të marrë celularin. Bitori ende flinte. Më parë kishin lexuar me zë për njeri-tjetrin. Mirëpo, 'leximi nuk ka nevojë për një audiencë tjetër, mbetet kënaqësi individuale', mendoi Elira. Dhe ishte ky motivi që asaj nuk i pëlqenin audiolibrat. Shqisa e saj e preferuar ishin sytë. Me ta arrinte të bënte bashkë grupe germash e togje fjalësh, i lidhte me hapësirat bosh midis, shkonte përpara e kthehej pas, qëmtonte paragrafin ardhës para kohe, e shtyrë nga kureshtja a nevoja për të kuptuar, pa qenë e detyruar të respektonte vijimësinë lineare të tekstit dhe, mbi të gjitha, mund të thërriste aty, në aktin e leximit, gjithë përvojën e saj jetësore. Kur për të lexonte një tjetër, atë e ngacmonte veç përpjekja e tij për të akruar, timbri i zërit, pauzat, të cilat janë momentet më personale gjatë një leximi. Prandaj, Elira e shmangte leximin

përmes një tjetri, përfshi shkrimtarët kur performojnë mjerueshëm me tekstet e tyre. Edhe tek Bitori nuk e kishte prekur tekstin, por fakti që lexonte pikërisht ai për një lindje, burri të cilit i ishte vënë kusht të linte domosdo me barrë një grua.

- Po. Atria është vajza e tij dhe personi i vetëm i dashur që i ka mbetur. Dhe ai do ta përdorë megjithatë për ta shkëmbyer si mall. Urrejtja për qytetin është më e fortë se dashuria e tij atërore. Duke ia dhënë nuse konsullit romak, Venero do të shpallë praninë e tij në rënien e Adrias.

Delino i kujtonte saktë fjalët me të cilat Avile i kishte hapur bisedën në shtëpinë e tij, disa orë më vonë, pas takimit në treg. E kishte ndihmuar të transportonte mallin dhe nga ai çast do vendosej tek shtëpia e mikut. Ishte Avile që e kishte ftuar që të mund të shmangte daljet e panevojshme rrugëve, por sidomos për ta penguar të linte qytetin me ngut tani që kishte ndërmend t'ia mbathte me një grua. Delino nuk është se vinte në dyshim përmbajtjen e bisedave të tij. Avile i kishte zbuluar të tjera informacione të nevojshme për Veneron dhe familjen e tij. Ajo që i bënte përshtypje ishte mënyra e tij e të folurit, stili, elokuenca, që vinin në dukje një farë niveli arsimimi, pavarësisht nga ajo që ai dinte, për të nisur edhe nga vetë pohimet e tij. Avile

kishte thënë se kishte qenë një shërbëtor i thjeshtë që fliste gjuhën e rrugës dhe, më e shumta që kishte mundur të arrinte në jetë ishte sigurimi i bukës së gojës prej daljeve në këtë treg për vite me radhë. Shtëpia e tij ishte e thjeshtë në fakt. U ngjante më shumë atyre palafiteve të lashta ndërtuar nga venetët e parë, ata që kishin themeluar qytetin, se sa një shtëpie të kohës. Ishte e gjitha prej druri, pranë kanalit të madh që lidhte qytetin me portin dhe detin. Vetëm themelet, në vend të pilotave të drunjtë, i kishte prej guri. Darkës kishin ngrënë një supë të shijshme me bathë dhe mish derri shoqëruar me verë.

Po kalohej edhe një herë në historinë e Delinos dhe Atrias që kërkojnë një rrugë arratie nga qyteti i vënë nën kërcënimin e një pushtimi të afërt nga romakët. Elira u shtrua mirë të lexonte.

Darkën e dytë Avile e kishte shtuar dozën. I kishte folur për vdekjen e papritur të Tulios, pronarit të fermës së kuajve, një vit pas ardhjes së djaloshtit kelt të quajtur Sedrik, tani një burrë ambicioz dhe me emër tjetër.

- Joshjet dhe vlerësimet e Flaminës, gruas bukuroshe të Tulios, në drejtim të partnerit të ri në biznes, tanimë pagëzuar Venero, paraprinë një zhvillim ekstrem, - kishte nisur rrëfimin e tij Avile gjithmonë me atë stilin e tij të lartë. I zbuloi pastaj Delinos, se kishte qenë ai vetë që i pat kapur në flagrancë. Pranoi më tej, se kishte bërë gabim të rëndë që nuk i pat treguar padronit të tij, Tulios. E kishte frikë gruan e tij Flaminën. Duhet të zgjidhte midis jetës së tij dhe asaj të Tulios.

Avile ndaloi pak dhe iu gëzua faktit që Delino i gJORË e dëgjonte me shumë vëmendje.

- Ndoshti që Tulio u "rrëzua" nga nga kali e vdiq, - vijoi ai. - Kaloi për aksident. Pak kohë më vonë, çifti doli zbuluar. Venero, me tregtinë e tij me Romën, përveç pasurisë, kishte ftuar shumë pushtet. Flamina e tij vdiq në lindje dhe Atria nuk e njohu dot nënën e saj.

Edhe ditën e tretë, mbyllur në atë dhomë pranë ujërave të kanalit të lundrueshëm, Delino kujtonte gjithë kohën bisedat e një nate më parë. Kishte diçka të magjishme dhe çarmatosëse në atë që ai rrëfente. Dhe Delino duhej të zgjohej, nuk mund të rrinte gjatë aty. I kishte paratë në xhep dhe, në fakt, shikonte me vëmendje mjetet e vogla të lundrimit që kalonin. Tani duhet ta harronte liburnën e tij madhështore. Duhet të gjente një barkë të vogël me dy palë rrema e të vozitnin bashkë me Atrian sa për të dalë nga qyteti. Pastaj do fshiheshin diku që të prisnin çastin e duhur për t'u ngjitur në ndonjë anije. Dhe, pikërisht, gjëja e parë për t'u bërë, ishte që të lidhej me Atrian dhe Avilen, i cili në këtë mes, nuk është se mund ta ndihmonte shumë, në fakt. Atje në treg, tre ditë më parë, i ishte fshehur vështrimit të Veneros, nga sa kishte kuptuar Delino. Ja, kjo ishte një pikë për t'u sqaruar. Delino nuk e kishte dëgjuar ende të fliste se çfarë raportesh kishte ruajtur Avile me Veneron.

Ishte ai çasti kur dielli zbriste mbi Konkarenë. Elira kishte një motiv të mirë për ta zgjuar Bitorin: të bënte dashuri. Pastaj, pas përdimit, duhet të nguteshin nëse do të donin të bënin ndonjë vizitë të shpejtë në parqet e gdhendjeve në shkëmb më të afërta. Mbërriti një bip tjetër dhe Elira i ra fare shkurt, vendosi të vazhdojë leximin.

Ditën e katërt Avile kishte ardhur tek Delino me një lajm që i preu këmbët. Kishte dëgjuar se Atria, para se të shfaqej atje në treg për të blerë unazën e saj, ishte kapur nga njerëzit e të atit teksa kërkonte të arratisë nga qyteti me një tjetër. Zhgënjimi i Delinos ishte i fortë. I tha menjëherë mikut të tij se do e linte fare këtë punë. Dëshira e tij për t'u kthyer në shtëpi kishte marrë goditje fatale. U habit dhe vetë se si tani e mendonte kthimin vetëm me të. Pas asaj që pat mësuar që bërë gati t'i jepte Aviles të gjitha paratë që t'i blinte mall e të shisnin bashkë. Avile sikur që rinuar fare nga reagimi i tij. Ishte i vjetër dhe një djallë pranë tij në këtë moshë do të thoshte shumë për të. Ashtu bëri. Të nesërmen Delino u bashkua me Avilen në treg. Si fillim vetëm do ta ndihmonte.

Nga autori ftues i Çmimit Kombëtar në Letërsi 2021

DURIM TAÇI

LAKIMI

roman



Këtë përzgjedhje të veprës poetike të Lulzim Tafës e lexova në dorëshkrim. Mendimi i parë, që më erdhi, ishte se parathënien mund ta bëja thjesht duke shkëputur vargje apo strofa nga poezi të ndryshme dhe t'i bashkangjisja njëra me tjetrën, diçka e ngjashme me punën e artistëve bashkëkohorë për të krijuar instalacionet. Ishte një mundësi që ma jepte vetë lënda poetike, që kisha në dorë, përzgjedhur nga tetë libra të autorit, botuar në Prishtinë gjatë një periudhe 30 vjeçare. Këtë punë e ka kryer Sali Bashota, i cili meriton një përgëzim të veçantë. Me përzgjedhjen e tij, Sali Bashota ka arritur të nxjerrë në pah një cilësi shumë të çmuar, të cilën sigurisht që e ka gjetur në krijimtarinë e Lulzim Tafës, por që, e shpërndarë në tetë botime të shtrira në një kohë historike me përmbyse rrënjësore për Kosovën, siç është robëria, çlirimi kombëtar e politik dhe ndërtimi i lirisë, me shumë gjasa do të mbetet pa u vënë re nga lexuesi. Fjala është për koherencën, një cilësi kjo fort e rrallë të poetit në përgjithësi e posaçërisht te poetët shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit XX e këndeje.

E përmenda qëllimisht kohën historike të Kosovës, në të cilën shtrihet jeta si poet dhe si njeri e Lulzim Tafës. Poezia e tij ka një lidhje ombilicale të pakëputshme me atdheun, domethënë me kombin e vet. Duke pasur parasysh tronditjet tektonike që ka pësuar koha historike e Kosovës gjatë kësaj periudhe, duket paraprakisht shumë e vështirë që poezia e tij, si pasqyrë dhe pasqyrim i këtij realiteti të atdheut ta ruaj koherencën e vet organike. Sepse vetë kjo kohë historike, në diagramin e saj, nuk ka vazhdimësi. Përkundrazi, ka thyerje dhe përmbyse rrënjësore. Poetit i është nevojitur një shqisë e caktuar, krejt specifike, përtej anatomisë së tij njerëzore për ta ndier, një sy po ashtu i veçantë, i cili nuk rri në ballë për të parë çfarë kanë së brendshmi të përbashkët këto copa të kohës historike, në sipërfaqe secila monolitike dhe përrjashtuese të njëra - tjetrës. Poetit i është nevojitur edhe zotërimi i mirë i një gjuhe, do të thosha apokrifë, për ta shprehur pikërisht këtë damar të brendshëm, të cilin doemos që e tendosin, e çojnë madje në zgrrip, por nuk e këpusin dot ngjarjet e mëdha historike, sado dramatike të jenë ato.

Ky damar përbën shpirtin identitar të shqiptarëve të Kosovës në këtë rast. Vepra poetike, që kemi në dorë, na dëshmon më së miri se Lulzim Tafa është i pajisur me atë shqisën specifike për ta ndier gjallimin e këtij damari. Ai është i pajisur edhe me atë syrin e veçantë për ta parë atë damar dhe zotëron gjuhën apokrifë për ta shprehur. Kapja me besim pas një damari të tillë e mbron poetin Lulzim Tafa nga rënia në pozita ahistorike, gjë që do ta dëmtonte kauzën e tij si poet mirëfilli shqiptar. Po aq, kapja pas këtij damari ruan, përtej trumhasjeve të kohës historike, një tipar aq të qënësishëm, siç është koherenca. Nisur nga poezia e tij, ne, si lexues, mund t'i identifikojmë pa zor të madh fjalët kyçe, që do të na çonin te ky damar e që janë: ëndërr, dhimbje, dashuri, hero e ca pak të tjera të kësaj gjinie, të cilat, për nga qëndrimi i poetit, e bashkojnë gjenetiksht një poezi të shkruar nga ai në vitin 1989, me një poezi të shkruar në vitin 1999 e një tjetër të shkruar në vitin 2019. Nuk është pak kjo që ka arritur poeti Lulzim Tafa. Janë shumë të rrallë poetët shqiptarë, bashkëkohës të tij, që e kanë arritur, edhe pse kanë filluar të shkruajnë njëherësh me të apo edhe më herët dhe vazhdojnë ende të shkruajnë e të botojnë.

Koherenca, për të cilën po flas, është sigurisht çështje stili. Madje, burimin e

Vëllimi poetik nga Lulzim Tafa

EKSPOZITË ME ËNDRRA

Parathënie nga Besnik Mustafaj

ka te vetë thelbi i stilit, në kuptimin që i jep Aristoteli stilit, kur thotë se stili është vetë personaliteti i poetit. Pra, përfundimi i një kohezioni të tillë nuk mund të reduktohet kurrë në një aspekt teknik apo formal të shkrimtarisë. Thënë në mënyrë të përmblodhur, aty përmbyset aliazhi i qëndrueshëm i botëkuptimit të poetit përkthazi me filozofinë, historinë, identitetin vetjak dhe kolektiv, moralin, etikën dhe estetikën, politikën dhe gramatikën me përvojën e drejtpërdrejtë jetësore dhe kulturore po ashtu vetjake dhe të bashkësisë, të cilës ai i përket me vullnet të lirë. Sa më në moshë të hershme të ngjizet ky botëkuptim, aq më e qartë bëhet rruga, nëpër të cilën do të ecë poeti gjatë viteve të ardhshme me imagjinatën dhe gjuhën e tij letrare.

Poezitë e kësaj përzgjedhjeje na dëshmojnë mjaftueshëm se Lulzim Tafa e ka hedhur themelin e botëkuptimit të vet shumë herët, kur nuk i kishte mbushur ndoshta as 20 vjet. Kjo nuk do të thotë se botëkuptimi i një poeti si Lulzim Tafa është një strukturë mendore e ngurtë. Jo,

kurrësi. Nga poezitë e tij mund të sillja shumë shembuj që nxjerrin në pah si ky botëkuptim është zgjeruar pareshtur, diçka e ngjashme grafikisht me rrathët e lisit, pra pa ikur nga boshti zanafillor. Ndërsa përvoja jetësore dhe kulturore edhe te poeti Lulzim Tafa si te çdo njeri është *pas définition* evolutive, dinamike, e mbushur me të njohura e të panjohura, me përsëritje të mërzitshme dhe me zbulime befasuese. Instikti i poetit dallohet tek aftësia e tij për të zgjedhur grimcat e arta në vandakun e përvojës së vet jetësore dhe po aq në përvojën e bashkësisë, ku ai bën pjesë. Pikërisht këto grimcëza të arta digjen së brendshmi për të energjizuar përfytyrimin dhe gjuhën e tij si poet. Nuk po flas për një rregull universal, por për poetin Lulzim Tafa. Kështu, pra, në veprën e tij ruhet koherenca nga një krijim te tjetri, ani pse janë të shkruara nëpër vite të ndryshme, kur Lulzim Tafa ishte djalos apo tani që është akademik.

Botimi në fjalë shoqërohet në përmbyllje me një lloj apendiksi të dobishëm për lexuesin, ku janë përfshirë shumë vlerësime

të larta e të merituar nga poetët të shquar shqiptarë dhe të huaj për veprën poetike të Lulzim Tafës. Po përmend vetëm njërin nga këto vlerësime, ardhur nga i paharrueshmi Ali Podrimja. "Këtë poet e shquan guximi intelektual", thotë korifeu i poetëve.

Çfarë ka parasysh ky mjeshtër me "guxim intelektual", kur është fjala për të tërhequr vëmendjen mbi veprën e një poeti? Në dijeninë time, ende nuk ka në literaturën botërore një përcaktim të pranuar pak a shumë unanimisht lidhur me çfarë është një intelektual, prej nga ne, në këtë rast, do të mund të niseshim për të nxjerrë si deduksion ato cilësi të Lulzim Tafës, të shfaqura në indin e tekstit të tij poetik, të cilat e kanë shtyrë Podrimjen drejt një vlerësimi të tillë vërtet të pazakonshëm për një poet. Në një pjesë të madhe të kulturave kombëtare nëpër botë, poetin nuk e rendisin në familjen gjithsesi laramane të intelektualëve. Madje, në epokën më të artë të poezisë, në Greqinë e vjetër, Platoni nuk u jep poetëve të drejtë qytetarie në Republikën e tij, duke i quajtur shturrës të mendjes së njerëzve me imagjinatën e tyre të molepsur. Por, në "Republikën" tonë shqiptare, poeti ka qenë gjithmonë i pranuar, madje ka patur vendin e vet të nderit, me kushtin që ta meritojë këtë vend. Sipas Podrimjes, përveç mjeshtërisë së lavdërueshme të të shkruarit poezi, Lulzim Tafa e meriton këtë vend nderi edhe në sajë të guximit intelektual.

Unë bashkohem plotësisht me mendimin e Podrimjes dhe po e sqaroj fare shkurtimisht ku e shoh këtë guxim intelektual të shprehur në poezitë e kësaj përmblodhjeje. Më kryesorja më duket shfaqja e poetit si njerëzisht krejt i çliruar nga tabutë. Dhe, në këtë gjendje mendore prej të çliruarit nga tabutë, qofshin ato morale apo politike, më i spikatur është qëndrimi i tij ndaj konceptit të "heroit". Lulzim Tafa ka një numër poezish me këtë temë, a thua se do t'i shkojë sa më thellë dekonstrukcionit të figurës folklorike, domethënë arkaike të heroit si epiqendër e jetës së shoqërisë së sotme shqiptare. Lulzim Tafa, në këtë rast, nuk mbetet në lojën sipërfaqësore të një poeti provokativ. Ai sillet si një poet i vërtetë ikonoklast, i cili është i vetëdijshëm se heroi i folklorizuar, i cili mbart të pushtuar mendësinë e shqiptarit, në të vërtetë po pengon modernizimin e shoqërisë shqiptare bashkëkohore të Kosovës, rrjedhimisht po e pengon këtë shoqëri ta ndërtojë e ta gëzojë lirinë kombëtare dhe politike, fituar me gjak e sakrificë të mëdha. Poezia e kësaj përmblodhjeje jep arsye për një analizë shumë më të gjerë të shpalosjes së poetit Lulzim Tafa si i çliruar nga tabutë, apo, thënë me fjalët e Podrimjes si guximtar intelektual. Por nuk është kjo parathënie vendi për një analizë të tillë. E rëndësishme për t'u mbajtur mend është se poeti ikonoklast Lulzim Tafa e ka krejt të qartë çfarë po bën: ai synon ta përcjellë sadopak çlirimin e vet në mendësinë e shoqërisë, të cilës i përket me vetëdije, por pa cënuar kurrësi nderimin e vërtetë për heronjt, të cilët kanë vendin e tyre të adhurimit në panteonin monumental të kujtesës kombëtare.

Pra, kush është poeti Lulzim Tafa? Në vend të një përgjigjeje me hamendësime nga ana ime, po sjell dy vargjet përmbyllëse të poezisë së tij "Poetët": *Fëmija i tepërt i secilës nënë/ Bëhet poet*. I bie kështu që ai është fëmija i tepërt i nënës së tij, për të cilin, domethënë, për këtë fëmijë të tepërt të nënës së vet, në poezinë "Letër Bujar Tafës" ai thotë: "U bëra zot ose vetja *m'u duk*". E ka fjalën për veten e tij.

Lulzim Tafa

Ekspozitë me ëndrra



NATA PI NATËN

nata sonte pi natën
as nginjet as ngopet
e etur pi dhe nuk e shterrë
e vetme, e tradhtuar nga yjet, hëna,
Rruga e Qumështit
nata nxin sterrë

nxirë sterrosur
në monolog filozofon
Askush s'do t'i shihnte
as yjet as hënën
pa mua të pacipën, terrplotën
në këtë dhë
pa drojë e drojtje
terrësoj gjithë botën
si e pafë

LULE PREJ ERRËSIRE

Lule prej errësire
me petale
dhe aromë terri
i shohin vetëm
lakuriqët e natës
të mbirë
nga heshtja
prej dheri

lule me bukuri
të padukshme
me petale
e nektarë
që kurrë
nuk mund
të bëhen
aerodrome
për bletët
nuk mund të jenë
busulla

HESHTJA I MBULOI

Heshtja i mbuloi fjalët hibride
prurje stuhish të vjetra
faraonike
mbarsur me erëra detare
dimërore
plazhesh memece
natyrash mortore
me veladone murgjesh
e maskuar
mbi vranësira muzgjesh
të plogshuar
heshtja e mefshët
lëviz e ligështuar
mbi harqe manastirësh
të rrënuar
ku bujtin
me trokun dhe galopin
e braktisur
në hipodrome
kuaj të plakur
heshtakë,
pa hingëllima
nën qiejt e kalëruar
vetëm prej skifterësh
me krahë të djegur
nga vetëtimat

Vëllim i ri poetik, *Onufri*

ELIDA BUÇPAPAJ

Skaterr

EPIGRAMË

Ndërzyesi virtual
ndërzen botëzën
e popullit
të rrjetit social
tufëzat dhe arëzat
fejsbukjane
ngjishen e ngjishen
prej ndërzimit
si shkalla superiore
e kulturimit

e presin me shtërzime
fejsbukjane
tufëzat dhe arëzat
ndërzyesin virtual
pa pallë por masovik
ndërzyesi dhe të ndërzyerit
kolektivizëm socpopullor,
patriotik

me zërin e shterrë,
pa tinguj,
të çjerrë
ndërzyesi agjitprop
pallon pa pallë
popullin virtual

kolkozi fejsbukian
lumturisht
i këndon pallimit
ndërzyesi prej lavdeve
këndellur
mbi kashtën e dafinave
nën sytë e zilepsur
prej lakmisë
shijon frutet e lavdisë

pa shpatë e pa pallë
ndërzyesi e të ndërzyerit
fërgëllojnë prej unitetit biologjik
nuk janë debilë

nuk janë qafirë
mendjen e kanë
plot e përplot me bërlllok
që rimon përputhshëm
me popull tallava,
patriot

PËRBALLË HIPOKRIZISË

përpëlitje fjalësh gjatë një ore të mpirë
prej karficave të hipokrizisë
me stërkëmbsha resh me brirë

vizatoj me fjalë naive ato që shikojmë
si fëmijët në kopsht
fjalët kapen dorë për dorë
në fjali të shkurta plot kureshtje
unë në pritje
palos me gishta një copë heshtje

me vetulla e qerpikë artificiale
në dritën e syrit më sheh
atë që mendon e fsheh
nën fjalë të zvarritura prej bezdisë
kasnece të hipokrizisë

qerpiku më dridhet prej ftohtësisë
në shtat më shkon korrent rrëqethje
me gishta përdredh e spërdredh
një copë heshtje

sa thjeshtë ta shihnim botën
me sy të ndryshëm
pa kurrfarë ndërlikimi
se të na shtrëngoje dara
me sytë e vëngërt të hipokrizisë
prej mosbesimi

me vetulla e qerpikë artificiale
në dritën e syrit më sheh
hipokrizia një korse e ngushtë tinzare
të mbyt pa pikë droje
unë me gishta pa pikë kureshtje
palos në katërsh një copë heshtje

UNË DHE ATDHEU

Midis nesh hyn mjergulla
turbullirë mohuese
na mbështjell secilin
si embrionet
në mitrën
e dy nënave
në polet e kundërta
të planetit tokë
e përhimtë oktapod
në krahët e saj të lluqta
krater përthithës
na përfshin butas fort
na përhumbe
në gjumin e harrimit klithës
pa ëndrra,
pa kujtesë në hiç
dy planete më vete
në humbësirën infinite
për mos
të larguar nga njëri-tjetri
nëpër qiejt të ndarë
me mure hekuri
në kozmos
na fundos

ELIDA
BUÇPAPAJ

Skaterr

OnufriPoezi



KËTË DITË DIELLI

Këtë ditë dielli,
Ky gem luleverdhtë thane
Është lastar i ëmbël dielli
Në hapësirë.

Këtë ditë dielli,
Buzëqeshja jote
Është një zog i bardhë dielli
Në gem thane.

Këtë ditë dielli,
Bota
Është një tingull i gëzuar dielli
Në buzëqeshjen tënde.

1972

MOJ E MIRA QË DEL TE KROJET

Ai s'erdhi më.
Vetëm unë te krojet.

Zogjve iu dhimba
Zogjtë
Ranë të hanë vajet e tyre.

Krojet u thanë.

Plasat e tokës
U ngopën me gurgullimat
E krojeve.

Ujku stërdhëmb i namës sime
Tufat e shqerrave s'i gjeti kurrë.

Shqerrat hëngrën deri te qielli
Rudinat e trishta
Të mallit tonë.

1972

BURIM I BARDHË! BURIM I BARDHË!

Burim i bardhë! Burim i bardhë!
Ëndrra ime
Që gumon kthjellët nga toka.

Sa herë kam pirë rrëkezën tënde,
Kam pirë gjoksin tim –
Etje –
Që etje din të shuajë.

Ahishtet
Ruajnë gonxhet e tua
Qielli
Të mos i gëlltisë kurrë.

Burim i bardhë! Burim i bardhë!
Toka mos është
Ëndërr e bardhë,
E shijuar nga të gjithë?

1972

PUTHJA

Më puthi pa e dashur me buzët si
akull,
M'i kaploi puthja e akullit ëndrrat e

Vëllim i ri poetik, Onufri

SKËNDER BUÇPAPAJ

Zogu i bjeshkës i riu

gjumin,
Më rëndoi në faqe
E m'u bë gur.

E çoi gurin te rruga e vërritarëve
Sërish rruga e shtrembët nën peshën
e rëndë
E sjell tek unë.

Mbeti guri
Për t'u shkrirë
Nga dy buzë të ngrohta që i dua unë.

1972

ZOGU I BJESHKËS

Cicëriu zogu i vogël i bjeshkës
e më fali lulet e malit,
e më fali larat e borës,
e më fali flladin e ashtës.

Cicëriu.

Cicëriu gjelbër,
cicëriu kaltër,
cicëriu kaltër e gjelbër,
cicëriu bukur zogu i bardhë i bjeshkës
e më fali verën.

1972

GJAKOVA

Gjakovën desha ta shikoja nga një
mesditë bjeshke,
mjegullat mbi të s'më lanë.

Gjakova
gjak.

Mjegullat kullojnë gjak,
kuqen fjalët, njerëzit
që rendin.

Çkaherë toka e kuqe dhe qyteti i kuq
dolën nga gjaku.

Gjakova,
belbëzim vigan gjaku
i dheut.

Gjakova,
dhimbë e ngurtë
që iu mbeti në fyt
shekujve.

Gjakova deshi të më shikonte nga një
mesditë vere,
gjakrat në sy s'e lanë.

1972

DJALOSH I GOJFILTË

- Requiem për Halil Bubrrrecin,
korrierin e çetave të lirisë, vranë
matanë majës së Bajrakes në
bjeshkë, në korrik të vitit 1944, në
moshën 14 vjeçare

Djalosh i gojfiltë

Flladi
I dritës
Luan melodi për ty
Në fyj të krojeve
Si zgjime të hutuara
Drerësh të breshtave.

Njëri sy meit i kryevrasësit
I flet syrit tjetër në agoni:
- Lule e zbehtë boronice
Ky djalë.

- Pushkë e keqe kjo për ju
(Që burra mos qofshi)
I fole ti kryevrasësit
Në syrin që veç veten shikon.

- Unë ta jap ty plumbin e fundit,
Të foli kryevrasësi
Me syrin që mezi përtej vetes shikon.

Të gjithë plumbat i mori
Koka e gojfiltë
Mbi lëndinën e blertë.


Të gjithë gjakun e mori
Lëndina e blertë
Nën kokën e gojfiltë.

Flladi
I territ
Dënes mrizeve përvjashëm
Si gjumi i trembur
I deleve pa bari.

I bëzani syri i fundit i kryevrasësit
Gjakut të gojfiltë të shndërruar në
muzg,
Kokërr e këputur loti
Pishnajash:

- Kurrë më s'do të prekësh krua
As kurrë më fyell me ato buzë s'do të
prekësh,
O djalosh i gojfiltë!

1972



Fragment nga romani, *Ombra GVG*

CHARLES KING

Mesnatë në Pallatin Pera

Përktheu nga origjinali: Zana Harxhi Baroni

Shënimi i autorit

Po shkruaj për një të kaluar komplekse, në të cilën mospërputhja e gjuhës është e pashmangshme. Përdorimi i emrit "Stamboll" haset përgjatë gjithë librit, ndonëse para vitit 1930 apo edhe mandej, shumica e vendasve dhe e të huajve e njihnin atë me variantin "Kostandinopoja". Përdorimi i fjalës "mysliman" nga ana ime ka si qëllim përshkrimin e njerëzve që do ta përdornin atë si një emërtesë në epokën osmane, pavarësisht nga niveli i tyre i përkushtimit fetar. Shumë prej këtij populli më vonë do ta quanin veten turq.

Njerëzit me origjinë greke ortodokse në Stamboll janë dalluar prej kohësh nga greqisht folësit që jetojnë në Greqi, dhe pikërisht këtu bëj një dallim të ngjashëm në anglisht. I jam referuar rrugës së sotme "İstiklal" (Pavarësisë) si "Grande Rue", një term që shumë njerëz vazhduan ta përdornin në vitet midis dy luftërave, edhe pasi rrugës iu dha zyrtarisht emri i saj aktual.

Përgjithësisht i shqiptoj leksemat turke sipas shqiptimit në gjuhën turke. Rastet të cilat përbëjnë përjashtim janë drejtshkrimet idiosinkratike që gjenden në burimet e shkruara, të cilat i kam lënë të pandryshuara, sikurse edhe për termat dhe emrat që kanë ekuivalente në gjuhën angleze (pra *pasha* dhe *jo pasha*).

U jam referuar disa personazheve historikë — veçanërisht myslimanëve turq — me një ose më shumë emra të caktuar deri në kohën kur ata adoptuan një mbiemër të trashëgueshëm të familjes, rreth vitit 1943. Para kësaj, individët zakonisht thirreshin me një emër të parë plus një emër të nderuar, të tillë si "Pasha" për gjeneralët ose administratorët e lartë, "Bej" ose "Efendi" për burrat e rangut dhe "Hanëm" për gratë me pozicione të ngjashme. "Ismet Pasha" do të ishte pra ekuivalent me "Gjeneral Ismet", ndërsa "Halis Beu" do të nënkuptohej si "Zoti Halis".

Kam përdorur kryesisht udhëzimet kryesore për të përshkruar planimetrinë e Stambollit, dhe pse mjafton t'i hedhësh një sy hartës për të kuptuar se kjo është e pasaktë; të pakta janë karakteristikat gjeografike që shtrihen vetëm në drejtimin lindje-perëndim ose veri-jug. Lagjja në majë të kodrës dikur e quajtur "Pera", sot mund të ndahet në shumë nënseksione të ndryshme, dhe shumica e tyre tanimë gjenden brenda rrethit komunal të Beyoğlu-së.

Sigurisht, nëse një lexues po përipiqet të gjurmtojë personazhet dhe vendndodhjet në këtë libër, këto detaje të imtësishtme të përdorimit nuk duhet të jenë pengesë. Në fund të fundit, Stambolli është një vend që di të mbyllë njërin sy dhe të falë.

Fragment nga romani, *Ombra GVG*

SANDRONE DAZIERI

Mbreti i parave

Përktheu nga origjinali: Edmond Çali

MË PARË

Colomba u përkul mbi Giltinë-në dhe e vërtetoi se kishte vdekur, ndërsa Dante iu drejtua i egërsuar Leo-s.

- Nuk ishte nevoja. Ta hajë dreqi, nuk ishte nevoja!

Leo futi një karikator tjetër në pistoletë, pastaj iu afrua Colomba-s.

- A ka vdekur?

- Po. - *O Zot, sa e vogël është*, mendoi Colomba. Nuk duhej të peshonte më shumë se sa dyzet kile. - Çfarë ishte ai shpërthim, Dante? - Një mik i vjetër i Giltinë-së u përpoq që t'i siguronte një rrugë për të ikur.

- Dhe për pak do t'ia kishte dalë mbanë, - tha Leo, duke marrë me forcë thikën që kishte braktisur Giltinë.

- Leo, kujdes se po prek provat, - tha Colomba.

- Çfarë hutaqi që jam.

Diçka në mënyrën se si i tha këto fjalë bëri që Dante-s t'i vinte një e dridhur në trup.

- Mos e prek! - bërtiti. Por ishte tepër vonë, sepse Leo e kishte goditur Colomba-n me thikë në bark dhe e kishte rrotulluar thikën duke ia hapur buzët plagës.

Colomba ndjeu sikur stomaku po i bëhej prej akulli dhe ra në gjunjë, pistoleta i ra nga dora, kurse duart iu mbuluan me gjak.

Pa Leo-n që goditi Dante-n me grusht duke e rrëzuar përtokë, dhe pastaj u përkul mbi Belyy-n. Plaku i nguli sytë me tmerr, duke mos qenë në gjendje që të luante nga vendi për shkak të dhimbjes së tmerrshme që i shkaktonte plaga te legeni.

- Në qoftë se më fal jetën të bëj të pasur, - i tha.

- *Dasvidania*, - tha Leo, dhe ia preu fytyrën me të njëjtën mospërfillje me të cilën pritët një fetë tortë.

Dante u zvarrit drejt Colomba-s, e shtrirë në pozicionin e fetusit, tashmë në një pellg gjaku.

- CC, - tha me lot në sy. - Mos lëviz. Tani të shtyp plagën. Të shtyp...

Leo kapi Dante-n me forcë dhe e ngriti në këmbë.

- Është çasti për të shkuar, - tha.

Dante ndjeu termometrën e brendshëm që e kapërceu nivelin dhjetë, njëqind, një mijë, dhe fytyra e Leo-s u bë një njollë e errët në cepin e një ekrani të madh në Berlin, mandej kalimtare që muaj më parë i kishte shkaktuar krizën nervore dhe përfundoi në klinikën zvicerane.

- Je ti, - pëshpëriti.

- Të lumtë, vëllaçko, - tha Leo, pastaj e shtrëngoi për gryke derisa Dante humbi ndjenjat dhe e hodhi në kurriz.



Që nga koha e Platonit!? Është mirë që gjërat zhduken, sepse mund të zbulohet sërish Amshimi, që të bëhen dy pjesët për metaforën e ditës: të mund të nuhatet

Mungesa e diçkaje në gjurmët karmike, kur djegin peshën e fjalëve me një fill më të hollë se harresa. Fill që mund t'më mbajë lidhur me vendin që bota

E quan të zbrazët, derisa të ngjashmit t'i lidhet për zemër. Më e bukura mbetet kur ai vrapon në libra estetike Të gjejë ku kam qenë e ku nuk kam qenë i çmendur.

Të dytën, në këtë poezi "filozofike":

SHTËPIA DADAISTE

Kur flasim në familje për mobilet e vjetra, divani ku rrimë shikon në ëndërr një vullkan. Baroku i pëlqen në zhgëndërr: janë në modë edhe e befta, e mprehta e drama. Ngrihet e ikën Platoni nga Republika, po mbetet Njëshi që lexon, si gjithmonë: lind secili me drurin e vet, Pinokun e habive, që pret ta marrë përdore Zana që lodhet nga mobilet e vjetra; apo me lexuesin që mban sytë nga ne, por fjalët i ka me vete. Mbetemi edhe ne që nisim debatin e vjetër me njëri-tjetrin: Është mirë apo keq - në kujtesën kozmike prapë s'e gjeti Idenë që e nxjerr shtëpinë tonë dadaiste nga ky thes Bukurie!

Në këtë tjetren:

KËNGA E BILBILIT

S'thërras më: "Natë e bukur!", kur Tutje dritares duken diku duart E buta të erës - në fytyrën prej shiu Të stinës s'i gjej më portretet që vetëm Unë i njihja. Ngulur në hënë të padukshme, Do ketë kyçur atje rrufenë e mahnitjes, Germat e saj prej zjarri. Do ketë Zhbërë fjalën "tungjatjeta". Shoshën E kohës, që me mbetjet e ditës Duhej të praronte tokën, do e ketë Bërë të paprekshme nga mallëngjimi. As Platoni s'e gjen rrugën në këtë terr idesh. Për ne mbetet e vetmja shpresë Ajo simulakra e këngës së bilbililit, Që njëherë, një agim, desh na preku ballin, Tek mbushte në paqe, si një katedrale, Boshin e madh - mike melankolinë.

Por a nuk është Platoni ai që i përcaktoi poetët si të padobishëm dhe të dëmshëm për menaxhimin e një shteti ideal, ndërkohë që filozofët janë të përshtatshëm për politikën e një shteti të drejtë?

KËNGË PËR NJË GJETH

Ai gjeth i vetmuar në dritare, s'e di as a pat emër, Kur i thashë se edhe vetë yjet Bien në humnerën e heshtjes; se vijmë e ikin, Si gjethet e yjet, edhe vetvetet tona.

U ndie i mikluar dhe i prekur, apo që ra Në pragun e dritares që ngjarje vetëm për mua! Kërkonte shokë, apo era e shtyu Prej shkakut se fryn mbi botë!

Në këtë cep të dheut, ku gazetata janë çështje e ditës, A pa se prapë emrat tanë mungonin! A ndoshta që vetë dekreti i Platonit Që vjen t'i nxjerrë poetët nga Republika!

Ca burra e gra që heshtur, pa turp, Zgjasin kokën në dritaret që hapin në kohë: Duke i rënë fyellit secili për qejfin e vet; Duke vdekur vetëm aq sa duhet, pa teprime, Si rënia e gjethit mbi xham!

Platoni, Migjeni, Whitman, Shekspiri, Ungaretti, Van Gogu, Horaci, Uliksi, Sokrati, Rreshpja, Theodore Roetke; dhe bashkë me ta edhe kuzhina, milingona, dritarja, divani, qielli, varri dhe gjithçka e prekshme dhe reale, por edhe ëndrra, fantazia, batica e iluzionit, rrufeja e mahnitjes, melankolia, bukuria etj. Lart e poshtë, brenda dhe jashtë. Lart mes stërholimeve të rafinuara mendore, poshtë në thirrjen drejt realitetit të përditshëm dhe brenda në hapësirat e një spiritualiteti të domosdoshëm dhe jashtë përsëri në vizionin e bukur dhe problematik të botës. Një udhëtim nëpër, shterues, i cili të lë me ndjesinë se ke kaluar Universin e dukshëm dhe të padukshëm. Sa e bukur që është liria!

Fragment nga romani, *Dituria*

VIRGJIL MUÇI

Tri jetët e zotit P.

Presidenti i Republikës së Vjollcave (të cilin, qysh nga ky çast e më pas, jemi të shtrënguar ta thërrasim zoti P. për shkak të funksionit të lartë që kryen) hapi sytë dhe, siç ndodh rëndom në kësi rastesh, iu desh një fragment sekonde të kalonte nga ëndrra në zhgëndërr. Vetëm një fragment: i gjatë sa përjetësia dhe i shkurtër sa një interval midis dy rrahesh zemre. Dhe ja, një ditë e re nisi dhe ai, mund të thuhet, ishte zgjuar plotësisht. Ndihej i qetë, i çlodhur dhe i ngopur nga gjumi i njënatshëm, si rrallëherë tjetër. Ndjenja e ankthit, pasigurisë dhe e frikës se diçka mund të ngjante përgjatë atij harku kohor, kur ai ndodhej në gjendjen e pavetëdijshmërisë që njeriu përjeton në gjumë, ndjenjë që e persekutonte prej kohësh, e cila vinte e merrte trajtë në çastin që përmendej dhe çelte sytë, tani u tret pa lënë gjurmë. Gjasat qenë që merita t'u takonte atyre havepe të vogla, të kaltra, që mjeku personal ia rekomandoi me aq zell, kur zoti P. i hapi zemrën dhe i rrëfeu për ndjesinë e pakëndshme, për të mos thënë të frikshme, që shoqëronte mëngjeset fill pas zgjimit; por po aq të ngjarë mund të kishte edhe fakti tjetër: qetësia ia behu menjëherë mbasi siguroi mandatin e dytë si president. Gjithçka rinisi të shkonte fjollë, ose të paktën kështu dukej, siç ndodh kur përmes dritares këqyr nga jashtë një skenë idilike familjare. Sa herë kthente kryet në të majtë e në të djathtë, e kapërthente një ngazëllim si ndonjë adoleshent që ka bërë seks për herë të parë dhe i duket sikur gjithkush e sheh i zilepsur për arritjen e tij.

Me të drejtë, po të mendosh që adoleshenti i dikurshëm sot është një politikan me një karrierë të shkëlqyer, i kurorëzuar me skeptrin e kreut të pushtetit të një vendi, kryefamiljari i një familjeje të mrekullueshme (me një grua të bukur në krah prej tridhjetë e pesë vjetësh që ia kënaqte egon, dy fëmijë, djalë e vajzë të mbarë, për të mos i ngrënë mësysh) dhe... Pyetja është: ç'mund t'i duhet një njeriu më shumë për t'u ndier i realizuar?

Ja dhe rituali i pas zgjimit: fillimisht nxjerr këmbët jashtë shtratit ngadalë e me kujdes, porosi e mjekut që lidhet me tensionin dhe e këshillon të mos kryejë veprime të befta dhe, paskëtaj, i fut në pantoflat që ndodhen për anash krevatit, të cilat të krijojnë përshtypjen sikur s'kanë lëvizur vendit prej kohësh. Kjo është lëvizja e parë, e shndërruar

tanimë në rutinë, me të cilën nis një ditë e zakonit. Më pas, me një rend e sërënditje sipas një regjimi ushtarak, vijmë veprimet që i paraprijnë daljes nga shtëpia dhe shkuarjes në zyrë: hyrja në banjë, derdhja e ujit të hollë me një ndjesi krenarie të shfaqur sheshit për prostatën e paepur, ndryshe nga ç'ndodh me një pjesë të mirë të bashkëmoshatarëve (ujët e trashë e zbraz rregullisht dhe me një përpikëri për t'u pasur zili, në mesditë), një dush i shpejtë që shkarkon e merr me vete rrënojat e fundit të mbetura nga gjumi i një nate më parë, roja, larja e dhëmbëve, veshja me kujdesin dhe sqimën e duhur, pasqyrë besnike e gjendjes shpirtërore (një vëmendje e posaçme i kushtohet përzgjedhjes së kravatës, e cila, në raste të caktuara e solemne, e kombinuar edhe me kostumin, pasqyron ngjyrat e flamurit kombëtar), mëngjesi i bollshëm i rekomanduar prej dietologut, që mbyllet me një kafe ekspres të pazëvendësueshme e të patjetërsueshme; çka paralajmëron pa u gabuar se shqisat janë gati të ndërmarrin aventurën e një dite të re, duke i prirë si busull e pagabueshme drejt së panjohurës.

Lypset të kemi parasysh se jeta e një politikani, sidomos atij që ndodhet në majën e piramidës shtetërore, është plot me të papritura, të këndshme e të pakëndshme. Dhe ai e di mirë këtë. Përvoja e gjatë në politikë me ulje-ngritjet e veta (ndonëse këto të dytat mbizotërojnë ndjeshëm mbi të parat), e ka përgatitur ta presë gjithçka me qetësi, pa e dhënë veten, madje edhe atëherë kur, për një arsye a një tjetër, ndodhet nën stres. Ndaj gazetarë e kolegë politikanë e thërrasin mes tyre "maska prej gome"; zor se mund të thuash me siguri kush ia ngjiti atë nofkë i pari. Afërmendsh, bëhet fjalë për një shtrembërim grotesk të së famshmes "maskë e hekurt" të delfinit fatzi të Francës së shekullit të tetëmbëdhjetë, plasur në qelitë e terrëta prej të vëllait, uzurpatorit të fronit, me një maskë që nuk ia shqisnin nga fytyra as ditën, as natën, as kur hante, as kur pinte.

Lavdi Zotit që nuk kam vëlla dhe, ç'është më e rëndësishme, jetojmë në shekullin e njëzetënjëte në një vend demokratik, i kishte pasë pohuar dikujt në mirëbesim, me njëfarë qesëndie - një prej armëve të veta të parapëlqyera - kur tjetri i pati përmendur ngjashmërinë dhe konotacionin mes dy shprehjeve.



BOTIME TË REJA NGA MINERVA

"BABAI I KONCEPTIT TË VETËVLERËSIMIT KA SHKRUAR KRYEVEPRËN E TIJ".
-Warren Bennis, Ph.D, autor i "Të bëhesh udhëheqës"

NATHANIEL BRANDEN

GJASHTË SHTYLLAT

E VETËVLERËSIMIT

Vepra përkufizuese mbi vetëvlerësimin
nga pioneri kryesor i kësaj fushe

Minerva

Louise Hay

Mund
ta shërosh
jetën
tënde

BESTSELLER NDËRKOMBËTAR
MBI 50 MILIONË KOPJE TË SHITURA

Minerva

Fragment nga romani, *Dituria*

ROBERT GALBRAITH

Zemër sterrë e zezë

1

*Përse sytë të prehen tek unë i le
Dhe frymën e mbajte njëfarë?
Kurrë nuk do të jetë për be
Si të mos kishte ngjarë.*

Mary Elizabeth Coleridge
Një çast

Mes gjithë çifteve të ulura në Bar Rivoli të Ritzit, atë të enjte mbrëma, dyshja që po dëfrehej qartas më shumë, në të vërtetë nuk ishte çift.

Kormoran Strajku dhe Robin Elakoti, detektivë privatë, ortakë biznesi dhe të vetëdeklaruar miq të ngushtë, po festonin ditëlindjen e tridhjetë të Robinit. Me të mbërritur në barin që i ngjasonte një kutie bizhuterish art deco, me mure prej druri të errët dhe të praruar e xhama akulli Lalique, kishin ndër të dy njëfarë paretie, ngase ishin të vetëdijshëm se ajo që e vetnija dalje që kur ishin njohur, pesë vjet më parë. Nuk kishin vendosur kurrë më parë të kalonin një mbrëmje jashtë pune në shoqërinë e njëri-tjetrit, pa praninë e miqve apo kolegëve të tjerë, apo pa pretekstin e ndonjë incidenti (para disa javësh kishte pasur një rast të tillë, kur Strajku i kishte shkaktuar ortakes pa dashje dy sy të nxirë dhe

i kishte ofruar darkën nga një restorant indian si dëmshpërblim).

Diçka edhe më e pazakontë, të dy kishin fjetur bollshëm dhe dukeshin më së miri. Robini kishte veshur një fustan kaltërosh ngjitur për trupin, me flokët e derdhur biondë të sapolarë, dhe ortaku i vuri re shikimet admiruese të pijetarëve meshkuj teksa ajo kalonte. I kishte bërë komplimente për gurin e opalit që i varej në gropëzën rrëzë gushës, i cili kishte qenë dhuratë nga prindërit për tridhjetëvjetorin e lindjes. Diamantet e vogla përreth tij krijonin një aureolë shndritëse në dritën e praruar të barit dhe sa herë që Robini lëvizte, nga thellësia e opalit vezullonin shkëndija flakë të kuqe.

Strajku kishte veshur kostumin e preferuar italian, me këmbishë të bardhë dhe kravatë të errët. Ngjashmëria me një Bethoven paksa mbi peshë dhe me hundën e thyer, ishte më e dukshme tashmë që kishte rruar mjekrën, por buzëqeshja e ngrohtë e kamerieres për Strajkun tek i sillte pijen e parë Old Fashioned, i kishte kujtuar Robinit diçka që kishte thënë për të Sara Shadllok, gruaja e ish-burrit të saj: "Seç ka një hijeshi të çuditshme, apo jo? Disi i shkalafitur, por s'është problem."

Sa gënjeshtarë: Sarës i pëlqenin burrat e pashëm dhe tërheqës, siç e tregonte gjuetia e vazhdueshme dhe me fund të suksesshëm ndaj Metjus!



Ulur përballë njëri-tjetrit në karriget me motive leopardi të tavolinës dyshe, Strajku dhe Robini e kishin thyer akullin e fillimit, duke folur për punën. Diskutimet për çështjet e fundit i shoqëruan gjatë koktejit të parë dhe të fortë, derisa të qeshurat e tyre përherë e më të larta zunë të tërhiqnin vështrimet e banakierëve dhe klientëve bashkë. Robinit filluan shpejt t'i shkëlqenin sytë dhe fytyra iu skuq lehtas, madje edhe Strajku, që ishte goxha më trupmadh sesa ortakja dhe më se i aftë ta mbante alkoolin, kishte pirë aq shumë burbon sa të ndihej optimist dhe i shpenguar.

Biseda u bë më personale pas koktejit të dytë. Strajku, që ishte djali i jashtëligjshëm i një ylli rroku, të cilin e kishte takuar vetëm dy herë, i tha Robinit se njëra nga motrat e tij me babë, Prudensa, kishte kërkuar ta takonte.

- Si i bie të jetë kjo? - pyeti Robini. E dinte që babai i Strajkut ishte martuar tri herë dhe që ortakja i saj ishte rezultati i një nate seksi me një grua që shtypi e përshkruante zakonisht, supergroupie, por për pjesën tjetër të pemës familjare, kishte ide të paqarta.

- Kjo është e jashtëligjshme tjetër, - tha Strajku. - Disa vjet më e re se unë. E ëma ka qenë aktore, e mban mend Lindzi Fantropin? Me racë të përzier. Ka pasur role kudo, në EastEnders, The Bill...

- Do që ta takosh Prudensën?
- S'jam i sigurt, - pranoi Strajku. - Sikur s'më mjafton të merrem me të afërmit që kam! Për më tepër është psikoterapist.

- E cilës rrymë?
- Jungiane.

Shprehja e fytyrës së tij, që mbartte një përzierje dyshimi dhe mospëlqimi, e bëri Robinin t'ia kryste të qeshurit.

- Ç'të keq ka të jesh psikoterapist jungiane?

- S'e di... nga mesazhet nuk duket keq, por...

Teksa Strajku rrekej të gjente fjalët e duhura, vështrimi i ra mbi panelin e bronzit të murit pas kokës së Robinit, që shfaqte Ledën e mbarsur nga Zeusi, në trajtën e një mjellme.

- ... tha që as ajo s'e kishte pasur të lehtë ta kishte për baba. Por kur mësova zanatin që bën...

Atij iu fik zëri. Piu edhe pak burbon.

- T'u duk e pasinqertë?

- Jo tamam e pasinqertë... - tha Strajku me një psherëtimë. - Por më ka ardhur në majë të hundës nga psikologët që më thonë pse jetoj kështu dhe çdo gjë e shpien tek e ashtuquajtura familja ime. Prudensa tha në një nga mesazhet, se ta falte Rokbinë kishte qenë "shërim"... Varja, - tha befaz Strajku, - ke ditëlindjen, ndaj të flasim për familjen tënde. Ç'punë bën babai yt? S'ma ke thënë asnjëherë.

- Oh, s'ta paskam thënë?! - pyeti Robini me njëfarë habie. - Është profesor i kujdesit mjekësor, prodhimit dhe riprodhimit të dhenve.

Strajku desh u mbyt me koktejin.

- Ç'ka për të qeshur? - pyeti Robini, e çuditur.

- Më fal, - tha Strajku, duke u kollitur dhe duke qeshur njëkohësisht. - Thjesht s'e prisja.

- Është një autoritet, që ta dish, - tha Robini, kinse e fyer.

- Profesor i kujdesit... Edhe një herë, ç'ishte pjesa tjetër?

- Mjekësor, prodhimit dhe riprodh...

Ç'paska për të qeshur kaq shumë? - tha Robini, ndërsa Strajku ia plasi një tjetër gazi.

- S'e di, mbase kjo puna e "prodhimit" dhe "riprodhimit", - tha Strajku. - Por edhe e dhenve.

- Specializimi i tij ka pesëdhjetë e dy shkronja. I kam numëruar kur isha fëmijë.

- Goxha mbresëlënëse, - tha Strajku, teksa kthente një tjetër gllënjë burboni, duke u orvatur të dukej serioz. - Kur filloi të interesohej për dhentë? E ka pasur gjithë jetën apo i tërhoqi vëmendjen ndonjë dele e veçantë kur...

- Ai nuk i shkep ato, Strajk.

Njerëzit kthyen kokat nga e qeshura e Strajkut.

- Vëllait të tij të madh i lanë trashëgimi fermën e familjes, ndaj im atë studioi shkencë veterinarë në Durham dhe, po, u specializua...

Mjaft qeshe, ç'është kjo punë! Është edhe drejtor reviste.

- Të lutem, më thuaj që është për dhentë!

- Po, ashtu është! Menaxhimi i dhenve, - tha Robini, - dhe para se të pyesësh, jo, s'kanë ndonjë rubrikë fotografish me delen më të votuar nga lexuesit.

Fragment nga romani, *Dituria*

MILAN KUNDERA

Festa e kotësisë

Përktheu Saverina Pasho

Aleni mediton për kërthizën

Ishte muaji qershor, dielli i mëngjesit po dilte nga retë dhe Aleni po ecte ngadalë nëpër një rrugë të Parisit. Vështronte vajzat e reja, që të gjitha tregonin kërthizën e zhveshur midis pantallonave me bel shumë të ulët dhe tishërteve shumë të shkurtra. Ishte i magjepsur; i magjepsur dhe madje i turbulluar: sikur pushteti i tyre joshës të mos përqendrohej më te kofshët, as te vithet e as te gjinjtë, por tek ajo vrimëz e rrumbullt, e vendosur në mes të trupit.

Kjo e nxiti të mendonte: Nëse një burrë (ose një epokë) e sheh qendrën e joshjes femërore te kofshët, si ta përshkruajë dhe përkufizojë veçantinë e këtij orientimi erotik? Aty për aty sajoi një përgjigje: gjatësia e kofshëve është imazhi metaforik i rrugës së gjatë dhe magjepsëse (prandaj kofshët duhet të jenë të gjata), që çon drejt përmbushjes erotike; në fakt, tha me vete Aleni, edhe në mes të aktit seksual, gjatësia e kofshëve i jep gruas magjinë romantike të së paarritshmes.

Nëse një burrë (ose një epokë) e sheh

qendrën e joshjes femërore në vithet, si ta përshkruajë apo përkufizojë veçantinë e këtij orientimi erotik? Aty për aty sajoi një përgjigje: brutalitet dhe hare, rruga më e shkurtër drejt qëllimit; qëllim edhe më eksitues, ngaqë është i dyfishtë.

Nëse një burrë (ose një epokë) e sheh joshjen femërore te gjinjtë, si ta përshkruajë dhe përkufizojë këtij orientim erotik? Aty për aty sajoi një përgjigje: shenjtërim i gruas; Virgjëresha Mari duke i dhënë gji Jezuit; seksi mashkullor i gjunjëzuar përpara misionit fisnik të seksit femëror.

Por si ta përkufizosh erotizmin e një burri (ose të një epoke), që sheh joshjen femërore të përqendruar në mes të trupit, te kërthiza?

Ramoni shëtit në kopshtin e Luksemburgut

Afërsisht në të njëjtë kohë kur Aleni ishte duke vlarë mendjen rreth burimeve të ndryshme të joshjes femërore, Ramoni ishte para muzeut që gjendet fare pranë kopshtit të Luksemburgut, ku po

ekspononin qysh prej një muaji tashmë tablo të Shagallit. Donte t'i shikonte, por e dinte se nuk do të gjente forcën të shndërrohej vullnetarisht në pjesë të asaj radhe të pambarueshme që zvarritej ngadalë drejt arkës; vëzhgoi njerëzit, fytyrat e ngrira nga mërzia, i përfytyroi aq mirë sallat ku trupat dhe dërdëllitjet e tyre do t'i mbulonin tablotë, saqë në krye të një minute u kthye mbrapsht dhe mori rruginën përmes parkut.

Këtu atmosfera ishte më e këndshme; njerëzia dukej si më e rrallë dhe më e lirshme: kishte nga ata që vraponin, jo se e kishin me ngut por sepse u pëlqente të vraponin; kishte syresh që shëtisnin duke ngrënë akullore; në lëndinë ishin ndjekësit e një shkolle aziatike që bënë lëvizje të çuditshme dhe të ngadalta; më tej, në një rreth të madh, ishin statujat e mëdha të bardha të mbretëreshave dhe zonjave të tjera fisnike të Francës dhe ende më tej, në lëndinë përmes pemëve, në të gjitha drejtimet e parkut, skulptura poetësh, piktorësh, dijetarësh; ai mbajti këmbët përpara një adoleshenti në bronz që, joshës, lakuriq, vetëm në të mbathura të shkurtra, i ofroi maskat që paraqisnin fytyrat e Balzakut, Berlioizit, Hygoit, Dumasë. Ramoni nuk e mbajti dot buzëqeshjen dhe vazhdoi endjen nëpër atë kopsht gjenish të cilët, modestë, të rrethuar nga shpërfillja e sjellshme e kalimtarëve, duhej të ndiheshin këndshëm të lirë; kurkush nuk ndalej për të vështruar fytyrat e tyre apo për të lexuar mbishkrimet në piedestale. Këtë shpërfillje, Ramoni e përthithte si një qetësi ngushëlluese. Pak nga pak, një buzëqeshje e gjatë, pothuaj e lumtur, iu shfaq në fytyrë.

Nuk ishte kancer

Pothuaj në të njëjtën kohë që Ramoni hiqte dorë nga ekspozita e Shagallit dhe vendoste të shëtiste në park, D'Ardelo ngjiste shkallët që të çonin në studion e mjekut të tij. Atë ditë, i binte të ishte fiksi tri javë para ditëlindjes. Që prej shumë vitesh, tashmë, kishte filluar t'i urrente ditëlindjet. Për shkak të numrave që mbartnin me vete. Megjithatë, nuk arrinte t'i shmange, sepse lumturia që ia festonin fitonte mbi turpin se po plakej. Aq më tepër që, kësaj radhe, vizita te mjeku i shtonte festës një ngjyrim të ri. Ngaqë sot ai duhej të mësonte rezultatet e analizave që do t'i thoshin nëse simptomat e dyshimta, të zbuluara në trupin e tij, shkaktoheshin nga kanceri ose jo.

Hyri në sallën e pritjes duke i përsëritur vetes së brendshmi, me zë të drithëruar, se për tri javë do të festonte lindjen e tij aq të largët dhe njëherësh vdekjen kaq të afërt; do të kremtonte një festë të dyfishtë.

Por sapo pa fytyrën e qeshur të mjekut, e kuptoi se vdekja nuk e kishte pranuar ftesën. Mjeku i shtrëngoi dorën vëllazërisht. Me lot në sy, D'Ardelo nuk mundi të shqiptonte as edhe një fjalë të vetme.

Studioja e mjekut ndodhej në bulevardin e Observatorit, nja njëqind metra larg nga kopshti i Luksemburgut. Meqë d'Ardelo banonte në një rrugë të vogël në anën tjetër, provoi t'i binte parkut mes përmes. Shëtitja në gjelbërim ia ktheu humorin e mirë gati në hare, kur kaloi anash rrethit të madh me statujat e mbretëreshave të dikurshme të Francës, të gjitha të gdhendura në mermer të bardhë, sa një bojë njeriu, në poza solemne që iu dukën qesharake, në mos gazmore, sikur ato zonja të donin të brohorisnin kësisoj lajmin e mirë që sapo kishte marrë. Nuk e mbajti dot veten dhe i përshëndeti dy apo tri herë duke ngritur dorën dhe shpërtheu në të qeshura.



KAPITULLI 1

Lëmshi që gjej në mëngjes më ndërmend që nuk jam më vetëm. Amanda është kthyer. Shoh rreth e rrotull e ndeshem me gjurmët e saj: mbi krahun e divanit pjata me bukën e thërrmuar, kurse në gotë ajo ç'ka mbetur nga pija. Në një qoshe, batanija e mbledhur shuk pranë librit përmbys, që vijon të jetë i hapur në të njëjtën faqe.

Kohët e fundit nuk e kam të lehtë gjumin, as e ndiej të lëvizë nëpër shtëpi. Vetëm kur rrotullohem nga njëra anë në brinjë, hapat e saj të vonë më mbërrijnë deri te dyshemeja e dhomës sime.

Nuk di se kur do të zgjohet. Pi kafënë, vë biskotat mbi tryezë bashkë me të vetmin filxhan që ka tepruar që nga koha e adoleshencës së saj. Nga dritarja, dielli që sa nuk na bie mbi kokë, ndriçon lopën me një fije bari në gojë.

Mbi sobë lë ibrikun bosh si për t'i thënë: ngroh qumështin. Mund ta përziejë me kafënë e mbetur në kafetierë, por edhe mund mos ta bëjë. Ka gjasë që ta vlerësojë përkujdesjen time për të, por po aq edhe mund të bezdiset që po trajtohet si kalama.

Nuk arrij t'i kuptoj turnetë e saj të punës, nëse mund t'i quaj të tillë; hyrjet e daljet janë të paparashikueshme. Gjithsecila pyetje imja në lidhje me këtë temë e acaroon. Përpiqem ta takoj vetëm në vaktet e të ngrënit.

Sigurohem që në frigorifer të ketë ushqim, në rast se nuk do të hajë mëngjes. Lëvizogat e përsosura të vezëve më japin siguri. Mbeti përherë e dobët ime bijë.

Heq nga tapeti këpucë e shapka, sistemoj divanin. Do të turpërohesha nëse do të vinte dikush e ta shihte dhomën në këtë gjendje. Poshtë batanijes, telefoni i Amandës është i fikur.

Tani mund të largohem. "Jam nga gjyshi sot", i shkruaj në një fletushkë. Ia lë afër vazos së tulipanëve të verdhë. I shtoj një zemër për të, të cilën e fshij vringthi.

2.

Im atë banon në gjysmë të rrugës midis fshatit e malit. Këtë mëngjes nuk ka shkuar në ara. Është ulur i kontraktuar mbi gurin e oxhakut. Në shtëpi koha nuk i ecën kurrë, leximi i ndonjë faqeje gazete e lodh, kurse televizori ka llafe shumë.

– Duhet të vish në një vend me mua sot, – thotë.

Dita është aq e kthjellët, sa gati na bën keq. Ai nuk ka mbajtur kurrë syze dielli, shtrëngon qepallat kur një rreze ia lëbyr shikimin. Nga kthesa në kthesë ngjitemi lart me makinën e tij "Fiat Brava"; njëri vesh më mbyllet, më pas edhe tjetri dhe e ndiej edhe më të fortë zhurmën e motorit. I përqendruar në dhënie e makinës, profili i tij shtrembërohet në çdo gropë të asfaltit, me hundën gjithnjë e më mprehtë, me buzët e përthithura nga brenda. Në një çast përmendet e më pyet për Amandën.

– E lashë duke fjetur, – i them.

Heshtim të dy.

Para nesh mali. Gjelbërimi i ri kacavirret në lartësi, ngjyros ahishtën shekullore e atë që barinjët e quajnë

Fragment nga romani, *Albas*

DONATELLA DI PIETRANTONIO

Mosha e brishtë

Përktheu: Diana Kastrati

lakuriqësi, aty ku pemët nuk rriten më e zë fill shqopishta. Përtej saj dimri vijon ende.

Pak e nga pak rruga i bëhet më e njohur. Kushedi se sa herë e ka bërë në këmbë e asokohe ishte ende e pashtuar ose thjesht shteg. Tani mund t'i japë makinës edhe me sy mbyllur. Shikon jashtë dritares së makinës: ka lindur aty poshtë, ku janë arat e mbjella e ku pas njëzet e pesë vjetësh pas lindjes së tij, linda edhe unë. Në këtë luginë ka qenë i ri, ndërsa unë vetëm një fëmijë. Më vonë qemë transferuar aty ku banon edhe sot. Këtu ka praktikuar gjahun e, me raste, edhe gjuetinë e ndaluar.

Ka shumë kohë që nuk ngjitemi bashkë në mal, sa nuk arrij t'i llogaris vitet. Hap paksa xhamin e merr frymë thellë. E harron emfizemën e mushkërive e ngushtimin e aortës, faqet me zgavra i gjallërohen. Ajri që ka lënë këtyre anëve i ka munguar përherë.

Mbërrijmë te vendi. Parkon në buzë të rrugës.

Kasollja e Sherifës mbahet ende në këmbë, edhe pa të. Mbjaj mend kur ulesha në mes të ekskursionistëve në tryezat e vëna në sheshin para kasolles, midis timit të mishit të pjekur ose kur i ndihmoja të shërbenin në tryeza, atëherë kur kishte

nevojë për ndihmë.

Drrurët e aheve gati cikin çatinë me gjetet e sapohapura.

– Kjo pjesë e pyllit është ende jona, mbaje mend për më vonë, – thotë im atë duke treguar me gisht pronën natyrore të familjes së tij.

"Për më vonë" do të thotë kur ai të mos jetë më. "Mund t'ia paraqes kërkesën Policisë Pyjore për të prerë dru për dimër", më shpjegon. E di fort mirë që nuk do ta bëjë, se nuk e ka gjetur kurrë të ndezur zjarrin në shtëpinë time.

– Më ke sjellë deri këtu për të më lënë pyllin? – bëj shaka.

– Nuk është vetëm kjo pjesë që sheh. Përshkon rrugën dhe futet në një rrugëz të përmbytur nga bari. E ndjek nga pas hapin e tij të stërmunduar, pa pikë qejfi.

Tabelën e kampingut nuk e mbaja mend të ishte kështu: i ka rënë ndonjë shkronjë, ndërsa M-ja është varur mbrapsht, duke u shndërruar në Ë. Një shermend shkurresh ka mbështjellë derën e hyrjes, e cila është e mbyllur me dry; nuk e dija që ai të kishte një çelës.

Shtyn me forcë kapakun e derës, kapërcen hekurat që ndeshen me dheun e bërë pilë, vijon të ecë drejt atyre pak

veprave muraturë e të rrënuara nga mospërdorimi. Poshtë strehës, rreshti i lavamanëve të vegjël për mysafirët, disa syresh të vandalizuar, njësoj si dyert e shkultura të banjave. Ecim përgjatë pishinës, ai gjithnjë disa hapa para meje. Mbeturina degësh të këputura në fund të pishinës, teksa një pemëz ka filluar të ngrëjë krye aty, e pasigurt, e gabuar. Më përtej, sheshet e tendave nuk dallohen më, i ka përpirë bimësia.

– Më thuaj, përse kemi ardhur këtu? Kush ta ka dhënë çelësin?

– Desha ta shohësh se si është katandisur ky vend.

Ngrita supet, e pashë. Mund edhe të ikim tani. Nuk kam asnjë interes për këtë vend.

– Edhe ky do të bëhet yti, më vonë, – më thotë ai.

Një sinjal alarmi më ngjitet nga stomaku në fyt. E mbyso.

– Nuk ka sesi. Ti e pate shitur këtë tokë.

Kishte provuar për një kohë të gjatë, por pa ia dalë mbanë, më rrëfeu. Mes korit të zogjve, nuk bëzaj për disa minuta. Në intervale të rregullta, veç zëri i qyqes.

– Pas ngjarjes nuk e donte askush, edhe nëse ia falja, – duket gati sikur do të justifikohet.

– As unë nuk e dua, të fut frikën ky vend.

Ngrita zërin, jehona i ktheu mbrapsht rrokjet e fundit. Por imi do të jetë gjithsesi, jam trashëgimtarja e tij e vetme.

– Një prej këtyre ditëve do të shkojmë te noteri për aktin e dhurimit.

Ja pushteti që im atë ushtron ende mbi mua: vendimet e marra tashmë prej tij që nuk mund t'i ndryshoj.

– Unë nuk do ta pranoj, kam mendimin tim tashmë.

I kthej shpinën dhe drejtohem për nga makina. Nuk i dëgjoj më tingujt e dashurisë së pyllit. Gjithë kjo këndellje e prillit nuk më përket.



Nata ka ardhur dhe ajo nuk i ka dëgjuar trokitjet, tek qëndron te dritarja duke vështruar kopshtin. Si i mbështjell errësira pa u ndier pemët e qershive. I mbështjell gjethet e fundit dhe gjethet nuk i rezistojnë errësirës, por e pranojnë atë duke pëshpëritur. E lodhur, me ditën thujse pas krahëve, gjithçka që do bëjë para gjumit dhe fëmijët e rehatuar në dhomën e ndenjes, e kaplon një ndjesi prehjeje për një çast ndanë xhamit. Sheh kopshtin që bie në errësirë, një dëshirë për t'u bërë njësh me këtë errësirë, për të dalë jashtë dhe për t'u shtrirë në të, të shtrihesh me gjethet e rëna dhe ta lësh natën të të kalojë, të zgjohesh pastaj me agimin dhe të çohesh e këndellur me mëngjesin që ka ardhur. Por këto trokitjet. Ajo i dëgjon teksa i përcillen në mendim, çokitja e prerë, këmbëngulëse, çdo trokitje krejt nën kontrollin e grushtit që e drejton, aq sa ajo fillon të rrudhë vetullat. Pastaj edhe Bejli troket në derën e qelqtë te kuzhina dhe i thërret, mami, duke bërë me gisht nga korridorin pa i hequr sytë nga ekрани. Ajlishi e gjen veten duke lëvizur drejt korridorit me foshnjën në krahë, hap derën kryesore dhe përballë xhamit të verandës qëndrojnë dy burra gati pa trajta në errësirë. Ndez dritën e verandës dhe ata mund t'i njohësh menjëherë nga mënyra si qëndrojnë, ajri i ftohtë i natës psherëtin teksa ajo hap derën e verandës, qetësia e lagjes së periferisë, shiu që bie thujse pa asnjë tingull në rrugën *Shën Lorenc* dhe mbi makinën e zezë të parkuar përballë shtëpisë. Çudi se si e mbartin me vete ata të dy ndjesinë e natës. Ajo i vështron që brenda instinktit të vet mbrojtës, i riu në të majtë pyet nëse e ka të shoqin në shtëpi dhe ka diçka në mënyrën se si e sheh, vështrimi i largët por zhbirues, që ngjan sikur përpiqet të mbërthejë diçka brenda saj. Sa hap e mbyll sytë ajo e ka kontrolluar rrugën majtas e djathtas dhe sheh një njeri që ecën i vetëm me çadër duke shëtitur qenin, shelgjet i tundin kryet shiut, në shtëpinë e Zajacëve kundruall shihet regëtimia e dritës nga një ekran i madh televizori. E mbledh veten dhe gati lëshon një të qeshur, një lloj refleksi universal i ndjenjës së fajit kur të vjen policia në derë. Beni zë e përpiqet në krahët e saj dhe polici i veshur civil në të djathtë, që është edhe më i vjetër në moshë vështron fëmijën, fytyra sikur i zbutet, prandaj ajo i drejtohet atij. E kupton se edhe ai është baba, të tilla gjëra kuptohen gjithnjë, ai tjetri është shumë i ri, shumë i mbajtur dhe truplidhur, ajo nis të flasë dhe papritmas ndien t'i merret zëri. Do kthehet shpejt në shtëpi, për një orë, doni që ta marr në telefon? Jo, nuk ka nevojë, zonja Stak, kur të vijë në shtëpi mund t'i thoni që të na marrë në telefon sa më shpejt që të mundet, ja dhe kartëvizita ime. Më thërrisni Ajlish, ju lutem, mund t'ju ndihmoj unë me ndonjë gjë? Jo, nuk ma do mendja, zonja Stak, është diçka për bashkëshortin tuaj. Polici më i vjetër në moshë po i buzëqesh me plot gojën fëmijës dhe për një çast ajo i sheh rrudhat rrotull gojës, një fytyrë e çuar dëm nga solemniteti, nuk është fytyra e duhur për këtë punë. Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, zonja Stak. Pse duhet të shqetësohem, nga Garda¹ jeni? Po, ashtu është, zonja Stak nuk duam t'ju lëmë akoma këtu jashtë dhe, kështu siç jemi qullur ne duke vajtur derë më derë, do ta kemi të vështirë të thahemi në radiatorin e makinës. Ajo e tërheq derën e verandës duke mbajtur në dorë kartëvizitën dhe qëndron aty duke parë dy burrat që kthehen te makina, sheh makinën që largohet në rrugë, frenon te kryqëzimi dhe dritat e pasme ndriçohen më shumë dhe marrin pamjen e dy syve të flakëruar. Ajo e hedh edhe një herë vështrimin nga rruga që tani i kthehet qetësisë së mbrëmjes, ndien afshin që vjen nga korridorin ndërsa futet brenda dhe mbyll derën, pastaj qëndron një çast duke këqyrur

¹ Në Republikën e Irlandës, *Garda Stochána* i referohet Policisë së Shtetit. Në këtë libër do të përdoret termi *Garda*.

Fragment nga romani, *Albas*

PAUL LYNCH

Kënga e profetit


Përktheu: Loran Gami

kartëvizitën dhe e kupton se gjatë gjithë kësaj kohe e ka mbajtur frymën. E kaplon një ndjesi se diçka është futur brenda në shtëpi, kërkon të ulë foshnjën, do që të ngrihet dhe të mendojë, duke parë se kjo gjë ndenji jashtë me ata dy burrat dhe pastaj u fut vetvetiu në korridor, diçka e paformë e megjithatë diçka që ndihet. Ajlishi e ndien teksa i përvidhet pranë ndërsa lëviz për te dhoma e ndenjes pranë fëmijëve, Mollin po mban telekomandën mbi kokën e Bejlit, duart e tij përplasen lart dhe ai kthehet nga ajo me sytë që i luten. Mami, thuaj ta kthejë te filmi im. Ajlishi mbyll derën e kuzhinës dhe e vendos foshnjën në djepin lëkundës, bën të largojë nga tryeza laptopin dhe ditarin e vet, por ndalon në vend dhe mbyll sytë. Kjo ndjesi që u fut në shtëpi e ka ndjekur nga pas. Sheh telefonin dhe e merr, dora ngurrton, i dërgon një mesazh Leri, e sheh sërish veten te dritarja duke vështruar jashtë. Atë kopsht që po bie në terr nuk e dëshiron më tani, ngaqë diçka prej asaj errësire ka hyrë brenda në shtëpi.

Leri Staku baret nëpër dhomën e ndenjes duke mbajtur kartëvizitën në dorë.

Ia ngul sytë duke rrudhur ballin, pastaj e vendos në tavolinën e mesit dhe tund kokën, lëshohet në kolltuk, me dorën që i mbërthen mjekrën teksa ajo e vështron në heshtje, duke e studiuar në atë mënyrën e vet të zakonshme, pas njëfarë moshe burri nuk mban më mjekër që të quhet burrë, por që të ndahet me të ritë e vet, nuk i kujtohet më se si duket i rruar. E sheh teksa këmbët i kërkojnë shapkat, fytyra i bie në qetësi ndërsa prehet në kolltuk, po mendon për diçka tjetër siç duket, derisa vetulla i tendoset dhe fytyra i ngriset dalëngadalë. Përkulet përpara dhe e merr sërish kartëvizitën. Ndoshta nuk është asgjë, thotë. Ajo e përkund fëmijën në prehër duke e vështruar ngultas. E si nuk qenka asgjë, Leri? Ai lëshon një psherëtimë dhe e kalon kurrrizin e dorës në gojë, duke u ngritur nga kolltuku zë e kërkon nëpër tavolinë. Ku e vure gazetën? Lëviz nëpër dhomë duke hedhur sytë as andej-kënde, por pa arritur të shohë, ndoshta e ka harruar fare gazetën, po kërkon diçka brenda hijes së mendimeve të veta dhe nuk arrin t'i bjerë në të. Pastaj kthehet dhe këqyr të shoqen teksa kjo mend foshnjën në gjë dhe kjo pamje e qetëson, një ndjesi jete e ngërthyer në një

imazh që e përjashton çdo ligësi dhe mendja fillon e i shpillet. Lëviz drejt saj dhe i afron dorën, por tërhiqet kur ajo e shënjestron me sy. Zyra Kombëtare e Shërbimit të Gardës, thotë ajo, ZKShG-ja, nuk janë dokudo ata, një inspektor te dera e shtëpisë, ç'punë kanë ata me ty? Ai tregon me gisht nga tavani, a do ta ulësh atë zërin? Futet në kuzhinë duke shtrënguar nofullat, merr një gotë nga mbajtësja dhe e lë rubinetin të rrjedhë, duke vështruar jashtë përtej pasqyrit të vet në errësirë, qershitë janë të vjetra dhe një ditë do të kalben, ndoshta do na duhet t'i presim në pranverë. E rrëkëllen gjithë gotën dhe shkon në dhomën e ndenjes. Dëgjo, thotë, dhe sikur e ndien zërin t'i mehet në një pëshpërimë. Asgjë s'do të jetë, me siguri. Ndërsa i thotë këto fjalë, ndien këtë besim që ka në vetvete t'i rrëkëllehet sikur uji i gotës t'i derdhej nëpër gishta. Ajo sheh se si i lëshohet sërish kolltukut, trupi që epet, dora që lëviz automatikisht kanalet e televizorit. Ai kthehet dhe e gjen veten të mbërthyer nga shikimi i saj dhe pastaj përkulet përpara dhe lëshon një psherëtimë, e tërheq mjekrën si të donte ta shkulte nga fytyra. Shiko, Ajlish, ti e di si veprojnë ata, se çfarë kërkojnë, mbledhin informata, e bëjnë me kujdes dhe, dashur padashur, edhe ti detyrohesh t'u japësh ç'të kërkojnë, pa dyshim që po mbledhin të dhëna për akuzat që po ngrihen ndaj ndonjë mësuesi, prandaj dhe ka kuptim që duan të flasin me mua, po na njoftojnë paraprakisht, ndoshta përpara se të bëjnë ndonjë arrestim, shiko, do t'i marr në telefon nesër ose pasnesër që të shoh se çfarë duan. Ajo e sheh në fytyrë e vetëdijshme për një ndjesi hiçi në thelb të qenies së vet, mendja dhe trupi kërkojnë sundimin e gjumit, pas pak do të ngjitet e do të veshë teshat e gjumit, duke parë orën të kalojë derisa të zgjohet foshnja për t'u ushqyer. Leri, i thotë ajo, ndërsa ai prapset sikur ajo t'i kishte kaluar rrymë elektrike nëpër duar. Ata thanë që t'i marrësh sa më shpejt që të kesh mundësi, merri tani në telefon, numri është te kartëvizita, tregoju që nuk ke asgjë për të fshehur. Ai vrenjtet në fytyrë dhe pastaj merr frymë me ngadalë si të ishte duke matur diçka që i përvijohet kërcënueshëm përpara syve, kthehet dhe e sheh Ajlishin drejt e në sy, me sytë e picërruara nga inati. Ç'do të thuaish tregoju që nuk kam asgjë për të fshehur? E kupton se ku e kam fjalën. Jo, nuk e kuptoj se ku e ke fjalën. Shiko, përdora thjesht një shprehje, Leri, të lutem shko dhe merri në telefon tani. Pse tregohesh gjithnjë kaq e vështirë, ta marrë drejt, thotë ai, dëgjo, nuk do t'i marr në telefon në këtë orë. Leri, merri tani, të lutem, nuk e dua hijen e ZKShG-së prapë te dera e shtëpisë, e ke dëgjuar se ç'thuhet, gjërat që flitet se po ndodhin këta muajt e fundit. Leri përkulet përpara në kolltuk dhe duket sikur nuk arrin të çohet prej andej, vrenjtet dhe pastaj lëviz drejt saj e ia merr foshnjën nga krahët. Ajlish, të lutem, më dëgjo pak, edhe ata duhet të tregojnë respekt ndaj meje, ata e dinë që unë kam angazhime, unë jam zëvendëssekretari i përgjithshëm i Sindikatës së Mësuesve të Irlandës, nuk pres të marr urdhra prej tyre. Ti mirë e ke, Leri, por atëherë përse të erdhën në shtëpi në këtë orë dhe nuk erdhën në zyrë ditën, pa më thuaj pak. Dëgjo, zemër, do t'i marr në telefon nesër ose pasnesër, tani, e mbyllim këtë muhabet se është natë? Trupi i qëndron përpara saj, megjithëse sytë i ka kthyer nga televizori. Është ora nëntë, thotë ai, dua të dëgjoj se ç'thonë lajmet, pse nuk është kthyer Marku në shtëpi? Ajo sheh nga dera, dora e gjumit i sillt rrotull belit, shkon te Leri dhe ia tërheq foshnjën nga krahët. Nuk e di, i thotë, nuk i vete më pas atij, kishte stërvitje futbollit në mbrëmje dhe mbase ka ngrënë darkë në shtëpinë e ndonjë shoku ose mbase ka shkuar te shtëpia e Samantës, nuk ndahen nga njëri-tjetri kohët e fundit, nuk e marr vesh se ç'i pëlqen asaj vajze.



Sa i fjalëpërfjalshëm duhet të jetë një përkthim letrar? Nabokovi, i cili fliste rrjedhshëm tri gjuhë dhe shkroi në dy prej tyre, besonte se “përkthimi më i papërpunuar i fjalëpërfjalshëm është njëmijë herë më i dobishëm se perifraximi më i bukur”. Borges, nga ana tjetër, mbronte pikëpamjen se një përkthyes nuk duhet të përpiqet ta kopjojë një tekst, por ta shndërrojë dhe pasurojë atë. “Përkthimi është një fazë më e përparuar e qytetërimit”, këmbëngulte Borges - ose, në varësi të llojit të përkthimit, “një fazë më e përparuar e shkrimit”. (Ai e shkroi rreshtin në frëngjisht, në njërin nga gjuhët që dinte.)

Në vitin 2016, “Vegjetariania” u bë romani i parë në gjuhën koreane që fitoi Man Booker International Prize, i cili iu dha autores Han Kang, dhe përkthyeses, Deborah Smith. Në botën anglishtfolëse, Smith, në atë kohë doktorante një njëzet e tetë vjeçare, studente që kishte filluar të mësonte gjuhën koreane vetëm para gjashtë vjetësh, u vlerësua gjerësisht për punën e saj. Megjithatë, në mediat koreane, ndjenja e krenarisë kombëtare që u shfaq pas fitores së Han Kang - për të mos përmendur rritjen e njëzetëfishuar të kopjeve të shtypura të librit, i cili ishte një sukses shumë modest me botimin fillestar, në vitin 2007 - u errësua shpejt nga akuzat për gabime në përkthim. Megjithatë Han e kishte lexuar dhe miratuar përkthimin, në gazetën *Huffington Post* të Koresë u shkrua se përkthimi nuk kishte arritur aspak të “qëllonte në shenjë”. Smith u mbrojt në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Seul, duke thënë: “Do t’i lejoja vetes mungesë besnikërie ndaj origjinalit vetëm për hir të një besnikërie më të madhe”.

Polemika arriti te shumë lexues amerikanë, kur *Los Angeles Times* botoi një shkrim nga Charse Yun, një koreano-amerikane që ka drejtuar kurse për përkthimin në Seul. (Artikulli çoi më tej një argument që Yun kishte bërë për herë të parë, në korrik, në revistën onlajn *Korea Exposé*.) “Smith e përforcon stilin e kursyer dhe të qetë të Han dhe e zbukuron me ndajfolje, mbiemra në shkallën superiore dhe zgjedhje të tjera fjalësh me emfazë që nuk janë askund në origjinal”, shkruan Yun. “Kjo nuk ndodh vetëm një ose dy herë, por pothuajse në çdo faqe”. Është sikur Rajmond Karver të ishte bërë të tingëllonte si Çarls Dickens, shton ai. Kjo nuk është, sipas Yun, çështje thjesht saktësie, por edhe e leximit të qartë kulturor. Koreja ka një traditë të pasur dhe të larmishme letrare - dhe një histori të kohëve të fundit që është e ndërlikuar ngushtë me atë të Perëndimit, veçanërisht me SHBA-në, por pak vepra të letërsisë koreane kanë pasur ndonjë sukses në botën anglishtfolëse dhe, pavarësisht nga prania e shpeshtë prania në titujt kryesorë të gazetave amerikane, ato nuk nguliten në imagjinatën popullore ashtu siç ndodh me librat nga fqinjët e saj më të mëdhenj Kina dhe Japonia. Han Kang dukej se e mbushte atë zbrazëti - ose filloi ta mbushte, të paktën. Por nëse sukcesi i saj varej nga gabimet në përkthim, sa kishte arritur vërtet të përkthehej?

“Vegjetariania” është në strukturë si fabul. Romani përqendrohet në vetëshkatërrimin e përshkruar me ngjyra të gjalla të një trupi të vetëm njerëzor. Ky trup i përket një gruaje të quajtur Jonhje, e cila përshkruhet nga bashkëshorti, zoti Çeong, si një grua pa asgjë të veçantë e cila “kurrësi nuk binte në sy”. Për zotin Çeong, i cili “ende nuk i kishte mbushur të tridhjetat” kjo është ajo që e tërhiqte. “Nuk shndriste nga nuri, megjithatë, nuk më ra në sy kurrfarë mangësie, ndaj edhe u bë gruaja ime”, thotë ai. Por ka një gjë që zotit Çeong e sheh si të veçantë tek ajo: kjo ishte beodia që ndiente ndaj

Versionet në gjuhën angleze të veprës së nobelistes Han Kang janë vlerësuar shumë. A janë besnike ndaj origjinalit?

HAN KANG DHE NDËRLIKIMET E PËRKTHIMIT

Jiayang Fan, *The New Yorker*

Përktheu: Granit Zela

gjokmbajtëseve, — thotë se nuk mund t’u duronte kur i shtypej gjoksi. Nuk pranon t’i mbajë, madje edhe në publik, madje edhe para miqve të bashkëshortit, edhe pse, thotë ai, “ajo gjoks për t’u mburrur, dhe të them të drejtën stili pa gjoksmbajtëse nuk i shkente kurrësi”. Për të ky është veprim i turpshëm.

Një mëngjes, zoti Çeong gjen gruan duke flakur në kosh mishin që gjendej në frigoriferin e tyre. Ajo është bërë vegjetariane, i thotë ajo, sepse “...pashë një ëndërr”. Më parë, ai mund të mendonte për gruan e tij “si një e huaj... dikush që shtron tavolinën dhe e mban shtëpinë në rregull.” Tani ai ndihet i turpëruar dhe i tradhtuar. Përfundimisht, lodhet nga veprimet e saj të çuditshme dhe fillon të përpiqet ta bind me forcë. Përballë një trysnie të madhe, Jonhje nuk thotë asgjë. Mosreagimi i heshtur ngjall, për të shoqin, imazhe nga e kaluara e Koresë si një komb

i pushtuar, dhe në rastet kur ai përdor dhunën për të kryer marrdhënie intime atij i duket sikur gruaja “shndërrohet në një nga ato të ashtuquajturat ngushëlluese – skllavet e seksit, të cilat u shërbenin ushtarëve japonezë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Vendimi i Jonhjes për të mos ngrënë mish pëballët me qortime të tmerrshme nga e gjithë familja, veçanërisht nga i ati, veteran i Luftës së Vietnamit, prirjet e dhunshme të të cilit nënkuptojnë traumat e fushëbetjes. (Më shumë se treqind mijë koreanë shërbyen së bashku me ushtarët amerikanë në atë konflikt.) Gjatë një vakti familjar, të orkestruar si një lloj mësymjeje, ai përpiqet të fusë një copë mish derri në gojën e të bijës. Si përgjigje, Jonhje pret kyçin e dorës ndërsa e gjithë familja e shikon me tmerr. Më në fund ajo përfundon në spital.

Afër fundit të librit, e motra, në dukje


më konvencionale, i bën një vizitë në spital psikiatrik. Kanë kaluar tre vjet nga darka familjare dhe ajo ka filluar të kuptojë se roli i saj si “besnikëria e saj, me të cilën ajo si bijë e madhe sillet me të atin, vinte jo nga rritja e hershme, por nga frika. E dinte që kjo ishte një nga mënyrat e vetme të mbijetesës”. Në spital, Jonhje është katandisur në tridhjet kilogramë. Duke refuzuar të flasë ose të pranojë ushqim në çfarëdo forme, ajo e ka harxhuar pjesën më të madhe të kohës duke u përpjekur të imitojë një pemë: rrinte kokëposhtë dhe rrezitej në diell. Han Kang ka thënë se personazhi i Jonhjes ishte frymëzuar prej një vargu të Ji Sang, poet modernist i fillimit të shekullit të njëzetë, i cili u censuroi shumë nën regjimin japonez dhe vepra e të cilit ngjall dhunën dhe agresionin e imperializmit. Ji e përshkroi mbylljen në vetvete dhe mosreagimin si një simptomë të shtypjes. “Unë besoj se njerëzit duhet të jenë bimë”, - shkroi ai.

Nëse Ji ishte konsumuar nga trauma kolektive e kolonializmit, Han përqendrohet në vuajtjet e një natyre më intime dhe personale. Por edhe letërsia e saj është e rrënjësor në historinë e Koresë. Kjo, sipas Çars Jun, është ajo që rrezikon të humbasë në përkthim. Një nga arsytet që “shumë lexues perëndimorë e shohin një pjesë të madhe të letërsisë bashkëkohore koreane si të papëlqyeshme”, shkruan ai, është pasiviteti i rrëfimitarëve. Smith, megjithatë, thekson “konfliktin dhe tensionin”, duke e bërë punën e Han më tërheqëse për lexuesit perëndimorë sesa mund të ishte një interpretim besnik. Kur Jonhje shpërfill një pyetje të të shoqit, për shembull, ai thotë se është “sikur të mos më kishte dëgjuar”, në përkthimin fjalë për fjalë të fragmentit nga Jun. Në versionin e Smith-it, bashkëshorti pohon se ajo “është krejtësisht e pavëmendshme ndaj marrjes në pyetje nga unë në mënyrë të përsëritur”.

Megjithatë, ajo që e bën Jonhjen një personazh ndikues nuk është çështje e ndonjë agresioni të shtuar apo një beteje më të hapur. “Vegjetariania” lexohet si një parabolë për rezistencën e heshtur dhe pasojat e saj; është gjithashtu një depërtim në kulturës koreane, ku çështjet e veprimit dhe mosveprimit kanë një kuptim të veçantë. Këto janë çështje thelbësore të veprës së Han Kang.

Han Kang u lind në vitin 1970 në Kwangju, një qytet provincial pranë majës së Gadishullit Korean me një popullsi, në atë kohë, rreth gjashtëqind mijë banorë. Babai, Han Seung-uon, është romancier i njohur dhe fitues i çmimeve të shumta letrare. (Në dekadën e fundit, Han ka fituar shumë çmime të njëjta.) Të dy vëllezërit e Han-it janë gjithashtu shkrimtarë. I ati ishte mësues dhe shkrimtar dhe familja zhvendosej shpesh për shkak të punës së tij. Si fëmijë, Han ndërroi pesë shkolla të ndryshme dhe ajo e kërkoi qëndrueshmërinë në libra.

Familja u largua nga Kwangju, për në Seul, në vitin 1980, kur Han ishte dhjetë vjeçe, pak pasi Çun Do-huan, një gjeneral me nofkën “Kasapi”, mori pushtetin me një grusht shteti dhe shpalli regjimin ushtarak. Demonstratat paqësore të studentëve në Kwangju ndeshën në dhunë: ushtarët qëlluan, sulmuan me bajoneta dhe rrahën protestuesit dhe kalimtarët. Një milici civile, e përbërë nga studentë dhe punëtorë, mori armë nga stacionet e policisë lokale dhe e detyruan ushtrinë të tërhiqej përkohësisht në periferi të qytetit. Ngjarja, e cila është krahasuar me masakrën e sheshit Tiananmen të Kinës, zgjati nëntë ditë; të paktën dyqind, në në mos dy mijë njerëz vdiqën (vlerësimi i qeverisë është rreth dhjetëfish më pak se të dhënat jozyrtare). Megjithatë familja e Han-it nuk pësoi humbje personale në



masakër, emri i qytetit të saj të lindjes u bë, për të, një metonimi për “gjithçka që është gjymtuar pa kthim”.

“Vepra njerëzore”, (Human Acts) romani më i fundit i Han-it, i përkthyer gjithashtu nga Smith, tregon historinë e masakrës. Fillon me një djalë pesëmbëdhjetë vjeçar, Dong-ho, duke pritur për një stuhi shiu dhe për kthimin e ushtrisë, që e ka mbushur qytetin me trupa të vdekur dhe e ka ndarë atë nga shoku i tij më i mirë. Dong-ho del për të kërkuar shokun e tij, por rekrutohet nga demonstruesit për të kataloguar kufomat e vendosura në një ndërtesë të qeverisë lokale. (Morgu është plot.) Atje djali ndeshet me sulmin metodik të vdekjes mbi mishin njerëzor - mënyra se si plagët e hapura kalben të parat dhe se si gishtat e këmbëve “të fryhen si zhardhokë të trashë xhenxhefil” në hijen më të frikshme të së zezës.

Vargjet e himnit kombëtar të Koresë së Jugut dëgjoheshin në mënyrë here pas hershme në ndërtesë; këndohen gjatë riteve mortore që po mbahen jashtë. Kur Dong-ho pyet pse të afërmit e të vdekurve këndojnë himnin - “Sikur të mos ishte vetë kombi ai që i kishte vrarë” - të tjerët reagojnë me habi. “Por gjeneralët janë rebelë, ata e morën pushtetin në mënyrë të paligjshme”, përgjigjet dikush. “Ushtarët e thjeshtë ndiqnin urdhrat e eprorëve. Si mund t’i quash ata një komb?” Dong-ho kupton se pyetja që ai dëshiron të bëjë me të vërtetë është shumë më e madhe, dhe më abstrakte, ose ndoshta janë disa pyetje rreth këmbënguljes së mizorisë dhe kuptimit të lirisë. Epifania e tij i bën jehonë asaj që motra e Jonhjes, arrin të kuptoj të “Vegjetaria”, se mbijetesa e saj nuk ka qenë një triumf, por e kundërta, sepse e ka arritur me çmimin e dinjitetit.

Në kapitullin e katërt, pasi ushtria ka rimarrë Kwangju-n, Dong-ho, me duart e ngritura në shenjë dorëzimi, qëllohet dhe vritet nga ushtarët. Secili nga kapitujt e romanit përqendrohet te një person i ndikuar nga jeta e tij e shkurtër: nxënësi i gjimnazit që rritet si redaktor i ngarkuar me censurimin e fakteve të masakrës; studentit i kthyer në të burgosur politik, i cili në fund kryen vetëvrasje; vajza e fabrikës që bëhet aktiviste e punës; Nëna e Dong-hos, e cila mbetet e përhumbur, çdo ditë, nga vdekja e të birit. Libri eksperimenton shumë me rrëfimin në vetën e dytë dhe Han luan me atë “ti” përgjatë gjithë librit, duke e brendashkuar lexuesin dhe duke na futur në rrënoja.

Kapitulli më i mrekullueshëm i librit është “Miku i djaloshit, 1980”, i cili përqendrohet te Jeong-dae, një shok klase i Dong-ho-s, i cili u qëllua për vdekje kur dy djemtë dolën për të parë turmat. Dong-ho u zvarrit në hijen e një ndërtese, duke parë këmbët e shokut të tij që dridheshin ndërsa përpjekjet e shpëtimit çuan në vrasjen e të tjerëve dhe, më në fund, ushtarët tërhiqnin zvarrë të vdekurit. Historia e Jeong-dae rrëfëhet nga shpirti i tij, i lidhur me kufomën e cila humb gjak në fund të një mali trupash në rritje, si një tullumbace e rrudhur, e kapur në degët e një peme. Ndërsa Dong-ho na mëson gjuhën e trupave të vdekur, Jeong-dae sqaron betejat e një shpirti ndërsa kupton vdekjen e trupit të vet. Shpirtrat që prekin njëri-tjetrin, por që nuk mund të lidhen plotësisht, përshkruhen si “flakë të trishtueshme që lëprijnë një mur të lëmuar xhami vetëm për të rrëshqitur pa fjalë, përtej çdo pengese që ekzistonte atje”.

Ndryshe nga Dong-ho, i cili përpriqet t’u bëjë qëndresë kujtimeve, duke i varrosur ato me turp, Jeong-dae kërkon strehim tek e kaluara si një mënyrë për të shmangur shikimin e kufomës së tij të copëtuar. Në librat e Han, ata që distancohen nga historitë e tyre janë të



destinuar të jetojnë jetë që nuk vlejnë më shumë se vdekja. Personazhet që përqafojnë tmerret e tyre të paktën kanë shpresën e lirisë. Shpërfaqja e historisë së kujtimeve të tilla është e dhimbshme, por sjell edhe lehtësimin prej diagnostikimit të plagës.

Në një ese rreth përkthimit të “Veprime njerëzore”, (Human Acts) botuar në revistën online *Asymptote*, Deborah Smith kur përshkruan leximin e veprës së Han tregon se si “magjepsesh nga imazhet e mprehta si brisk që dalin nga teksti pa u përshkruar drejtpërdrejt atje”. Ajo citon disa nga “ndërkalljet e saj shumë të rastësishme”, duke përfshirë frazën goditëse “flakë trishtuese që lëprijnë një mur të lëmuar xhami”. Charse Yun, në esenë për “Vegjetaria”, shpall admirimin për punën e përkthyeses, por argumenton se libri është një “krijim i ri”. Smith këmbëngul se frazat që ajo shtoi janë imazhe “të ngjallura aq fuqishëm nga gjuha koreane sa ndonjëherë e gjej veten duke kërkuar më kot tekstin origjinal, e bindur se ato ishin diku atje, aq qartë sa janë në kokën time”.

Kjo nuk është ajo që zakonisht nënkuptohet me përkthim. Mund ta krahasosh me punën e përbashkët të një shkrimtari dhe një redaktori; Han ka thënë se procesi, për të dhe Smithin, përfshinte shumë kthime pas, “si në një bisedë të pafund”. Më kujton gjerësinë e “imitimeve” poetike të Robert Lowell-it. (Jun citon “Cathay” të Ezra Pound.) E megjithatë ajo që Smith përshkruan është efekti që çdo shkrimtar mund të shpresojë të ketë te lexuesi i tij: një ndjenjë kaq e brendshme sa që duket sikur ajo e kishte kthyer tekstin në përvojën e saj. Gjithashtu duket thëllësisht në harmoni me qëllimin e Han Kang si shkrimtare.

Në vitin 2015, Han shkroi për një seminar përkthimi që ndoqi në Angli, gjatë të cilit Smith dhe të tjerë punuan për të përkthyer një nga tregimet e saj nga gjuha koreane në anglisht. Në një ese në lidhje me përvojën, Han përshkruan një ëndërr që pa kur ishte atje. “Dikush ishte shtrirë në një shtrat të bardhë, dhe unë po e shikoja në heshtje,” shkruan ajo. (Eseja u përkthye gjithashtu nga Smith.) Megjithëse fytyra e figurës së fjetur ishte e mbuluar nga një fletë e bardhë, ajo mund të dëgjonte se çfarë po thoshte personi.

“Më duhet të ngrihem tani... jo, kjo është shumë e sheshtë.” Pastaj “do të më duhet të ngrihem tani...jo, kjo është shumë e butë.” Dhe: “Duhet të largohem nga ky shtrat...jo, kjo është e pakëndshme”. Një përkthim i mirë, duket sikur sugjeron nëndërgjegjja e Hanit, është një gjë e gjallë, që merr frymë, e cila duhet kuptuar në termat e vet, e zbuluar nga poshtë fletës së madhe, të bardhë. Han kujton: “Në seancën e atij mëngjesi, të gjithë u kënaqën duke dëgjuar për ëndrrën time. (Kam kuptuar se është e mundur që makthi i dikujt të bëjë shumë njerëz të lumtur”).

“Veprime njerëzore” përfundon me një kapitull të titulluar “Shkrimtari, 2013”, i cili ka të bëjë me Han. (Libri u botua në Korenë e Jugut një vit më pas.) Në të, mësojmë se Dong-ho është një person real, jeta e të cilit u mbivendos me atë të Hanit në mënyrë të pashlyeshme. Në një intervistë të vitit 2016, Han tha se shkrimi për Jeong-dae dhe Dong-ho ishte aq torturues sa ajo shpesh shkruante vetëm tre ose katër rreshta në ditë. Për të shkruar për masakrën e Kwangju, shpjegon në libër, ajo kishte planifikuar të shqyrtonte dokumentet historike, por e pa veten të paaftë për të vazhduar, “për shkak të ëndrrave”. Në njërin, ajo mori vesh lajmin e një ekzekutimi masiv që nuk kishte fuqi ta ndalonte. Në një tjetër, asaj iu dha një makinë kohe dhe u përpoq menjëherë ta zhvendoste veten në 18 maj 1980.

Ndoshta është shpresa e çdo shkrimtari që të ketë një nëndije të lidhur kaq fort me veprën e saj, por ëndrrat e Han - ku personazhet shfaqen, si “përmes zëmres së një flake që rrënon”, siç shprehet ajo në intervistë, e cila u përkthye gjithashtu nga Smith, janë të njomur nga djersa, nga marrja në pyetje e vetes, përvoja në të cilat ajo është njëherazi viktimë dhe agresore. Tmerret mund të ndryshojnë për Han dhe Jonhjen, por ata janë nxjerrë nga i njëjti vend i errët, ku kujtimet e mizorisë vazhdojnë dhe marrin jetën e tyre fantazmagorike.

Në tetor, Han shkroi një shkrim për *Times* rreth botëvështrimit të Seulit, teksa Koreja e Veriut dhe Shtetet e Bashkuara u përfshinë në një fatkeqësi diplomatike potencialisht shkatërruese. Herë pas here, të huajt raportojnë se koreano-jugorët kanë një qëndrim misterioz ndaj Koresë

së Veriut, shkruan ajo. “Edhe pse pjesa tjetër e botës e shikon veriun me frikë, koreano-jugorët duken jashtëzakonisht të qetë”. Por kjo është thjesht sipërfaqja, këmbëngul Han: “Tensioni dhe terrori që janë grumbulluar për dekada janë varrosur thellë brenda nesh dhe janë shfaqur me shkrepitje të shkurtra”. Për Han, projekti i të shkruarit është, ashtu si përkthimi, një lloj zbulimi: ajo duhet t’i zhvarrosë këto ndjenja të varrosura dhe t’u kthejë një ndjenjë lirie si personazheve të saj imagjinare, ashtu edhe atyre, jeta e të cilëve i frymëzon ata.

Në romanin “Libri i bardhë”, një vepër e përkthyer nga Smith dhe botuar në Mbretërinë e Bashkuar, Han reflekton mbi dhimbjen e nënës së saj për humbjen e një vajze të mitur dhe mediton mbi aktin e zisë. Ngjyra e bardhë shërben si simbol i vdekjes, pikëllimit, lindjes dhe krijimit artistik; Han lë disa faqe bosh në libër. (Dikush mendon për makthin e saj rreth përkthimit, në të cilin një fletë e bardhë mbulon frazat që po përpriqet t’i kuptojë mirë.) Ajo shpjegon se donte që shkrimi i saj “të shndërrohej, në diçka si vaji i bardhë i përdorur për ënjtjet, si garzë e vendosur mbi një plagë”. Para së gjithash, i duhej të shkruante për dhimbjen e vdekjes së motrës, sepse “fshehja do të ishte e pamundur”.

Në mars, presidentja e Koresë së Jugut, Park Geun-hye, babai i së cilës, ushtaraku i fuqishëm Park Chung-hi, ishte president gjatë Luftës së Vietnamit dhe u vra disa muaj para grushtit të shtetit të 1980-ës, u rrëzua nga pushteti për shkak të korrupsionit. Skandali tronditi vendin. Në shkrimin e Han te *Times*, ajo kujton një seri demonstratash në të cilat mori pjesë, përpara se Parku të largohej nga detyra. Ishte një nga mitingjet më të mëdha të qytetarëve në historinë koreane. Protestuesit fikën qirin për të simbolizuar errësirën që po pllakoste. “Ne donim të ndryshonim shoqërinë vetëm përmes mjetit të qetë dhe paqësor të dritës së qirinjeve”, shkruan Han. Është një veprim që mund të ishte huazuar nga imagjinata ose nga ëndrrat e saj. Flaka është një gjë kalimtare dhe e brishtë që mund të shërbejë menjëherë për të përkujtuar të vdekurit dhe për të ndriçuar rrugën për të gjallët.



KALENDARI I PROMOVIMEVE NË STENDËN “ONUFRË”

E mërkurë, 13 nëntor

Ora 18.00
Bashkim Hoxha
“Shtëpia e verdhë”

Ora 12.00
Gjovalin Gjadri
“B2”

Ora 13.00
Ndue Ukaj
“Shtegu i të verbërve”

E enjte, 14 nëntor

Ora 11.00
Granit Zela
“Përmbytja”

Ora 14.00
Ballsor Hoxha
“Bora dhe unë”

Ora 17.00
Sokol Zekaj
“Koha e qytetit”

Ora 16.00
Lulzim Tafa
“Ekspozitë me ëndrra”

Ora 18.00
Alfred Lela
“Solo”

Ora 17.00
Primo Shllaku
“Nata e qejve”

E premte, 15 nëntor

Ora 18.00
Nasi Lera
“Vit pa pranverë”

Ora 18.00
Besnik Mustafaj
“Porta e ngushtë e purgatorit”,
“Libri i bletës”

Ora 19.00
Oltsen Gripshin
“Neuroestetika e një artisti”

E shtunë, 16 nëntor

Ora 11.00
Odiseas Elitis, “Aksion Esti”
Me përkthyesin Niko Kacalidha

E diel, 17 nëntor

Ora 13.00
Ajne Iberhysaj
“Gravurë me ngjyrat e kohës”